



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.06.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Seancë dëgjimore me kërkesën e një grupi deputetësh të Komisionit me kryeredaktorin e gazetës opozitare “Rilindja Demokratike”, zotin Bledi Kasmi, për dhunën e ushtruar ndaj tij nga forcat e Policisë së Shtetit gjatë raportimit mediatik të protestës së datës 26 maj 2018.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Fatmir Velaj, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Kejdi Mehmetaj, Nora Malaj, Ilir Beqaj (zëvendësues) dhe deputetë të tjerë të opozitës.

Mungon:

Almira Xhembulla.

Të ftuar:

Bledi Kasmi – kryeredaktor i gazetës “Rilindja Demokratike”.

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi - Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Kjo është një dëgjese e thirrur nga deputetët e opozitës, të Partisë Demokratike dhe të LSI-së në komision, në lidhje me dhunën e ushtruar në protestën e fundit të opozitës ndaj kryeredaktorit të gazetës së parë opozitare, por edhe më të madhe në vend, zotit Bledi Kasmi.

Pavarësisht se deputetët e maxhorancës u përpoqën të zhduknin edhe kopjet e deklaratave, edhe kopjet e kërkesës për dëgjese në mbledhjen e fundit, u detyruam t'i ribënim disa herë. Më vjen mirë që sot ju nuk keni urdhër të bojkotoni këtë seancë, sepse liria e shtypit, liria e medias është një prerogativë për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.

Të gjithë e dimë që misioni i medias është që t'u shërbejë qytetarëve, duke i informuar ata më së miri. Media informon, edukon, formëson opinionin publik dhe është faktor kryesor në vendimet politike të një vendi. Informimi i qytetarëve është kusht themelor në demokraci dhe tregues i shkallës së lirisë së tij. Pra, të gjithë e dimë se pa medie të lira, nuk ka demokraci.

Unë do të doja që para se t'i kaloja fjalën zotit Kasmi, t'i referohesha, më saktë të citoja atë çka Johanesh Han ka thënë në konferencën e zhvilluar në Tiranë: "BE, Ballkani Perëndimor, ditët e medias", në dhjetor të vitit 2017, ku ka deklaruar: "Liria e shprehjes është një nga elementet kyçe të procesit të integritetit dhe të hapjes së negociatave për pranimin e vendeve kandidate në BE". Me vendet kandidate - vazhdon Johanesh Han, - për anëtarësimin e Ballkanit Perëndimor me të cilët kemi filluar negociatat e anëtarësimit, po shikojmë kapitujt 23 dhe 24, që merren pikërisht me lirinë e medias. Ne, - vazhdon Johanesh Han, - do të këqyrim me kujdes lirinë e shprehjes dhe të medias për të gjitha vendet që dëshirojnë të hapin negociatat dhe, më pas, të vazhdojnë procesin e integritetit". Pra, është një mesazh shumë i qartë, sidomos për censorët e lirisë së shtypit dhe censorët e opozitës.

Unë dua t'ju kujtoj se sot është data 4 dhe kemi vetëm 24 ditë deri në vendimin për hapjen apo jo të negociatave me Shqipërinë. Me këtë rast dua t'ju kujtoj se opozita do të vazhdojë të bëjë rolin e saj për t'ju kujtuar çdo ditë se duhet të filloni të plotësoni të gjitha kriteret një e nga një, duke filluar që nga ai politik, ku përfshihet liria e shprehjes, liria e shtypit dhe liria e medias, duke vazhduar më tej, ku të dëshmoni se e keni seriozisht luftën ndaj krimit, ndaj drogës, reformën në drejtësi dhe të drejtat e njeriut.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka kërkuar fjalën për procedurë, zonja Rista.

Adelina Rista – Faleminderit, zonja kryetare!

Sot është data 4 vërtetë dhe starton matura shtetërore, janë 37 mijë maturantë që testojnë njohuritë e tyre në provimin e parë, atë të gjuhëve të huaja. Ne, si Komision i Edukimit, mendoj se na takon t'u urojmë suksese të gjithë maturantëve që sot testojnë njohuritë e tyre në provimin e parë të maturës shtetërore!

Gjithashtu, duhet t'u urojmë suksese edhe forcave policore që janë angazhuar për të ruajtur rendin dhe qetësinë, për mbarëvajtje në provimin e maturës shtetërore!

Unë them se sot të gjithë si komision, sepse jemi komisioni që mbulojmë edhe çështjet e arsimit, duhet t'u urojmë suksese të gjithë maturantëve, arsimit shqiptar, sepse në fund të fundit shkolla është kudhra ku kalitet dhe farkëtohet dija!

Faleminderit!

Albana Vokshi- Faleminderit, zonja Rista!

Ju falënderoj që na e kujtuat!

Besoj se të gjithë si komision jemi dakord t'u urojmë të gjithë maturantëve suksese!

Të përgëzojmë policinë kur bën punën e saj, por jo kur tejkalon të gjitha kompetencat dhe në shkelje të ligjit ushtron dhunë ndaj protestuesve që dalin për të protestuar ndaj skandaleve të qeverisë apo kur ushtron dhunë ndaj medias dhe shtypit të lirë.

Zoti Bledi, po ta jap fjalën. Pastaj do të kalojmë te pyetjet.

Bledi Kasmi – Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për ftesën që më keni bërë në këtë seancë dëgjimore në lidhje me incidentin e dhunshëm të protestës së datës 26 maj ndaj meje!

Fillimisht do ta nis me një falënderim drejtuar kolegëve të organizatës ndërkombëtare të *Reporterëve pa kufij*, e cila ka dënuar dhunën ndaj meje dhe, në të njëjtën kohë, i ka bërë thirrje kreut të qeverisë të dënojë këtë dhunë.

Dua të falënderoj gjithashtu Organizatën e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë, e cila u është bashkuar *Reporterëve pa kufij*, duke dënuar dhunën dhe duke kërkuar dënimin e kësaj dhune nga Kryeministri.

Unë kam një karrierë të gjatë pune si gazetar, rreth 24 vjet. Kurrë ndonjëherë në jetën time nuk kam pasur ndonjë problem me ligjin, aq më pak me forcat e policisë. Gjithmonë kam inkurajuar dhe kam mbështetur punën e tyre, duke qenë i ndërgjegjësuar se detyra e tyre është mjaft e vështirë, sidomos në këto momente.

Do të doja të ilustroja një rast nga puna ime, në mbështetje të forcave të policisë në protestën e një viti më parë, kur u dogj bunkerit. Të gjithë e mbani mend se aty pati edhe incidente të forta me policinë. Unë kam qenë duke ushtruar edhe atëherë detyrën e gazetarit, duke bërë fotografi dhe duke raportuar për gazetën. Në një moment vjen një kordon i forcave speciale që vinte nga Drejtoria e Burgjeve në drejtim të protestuesve. Situata ishte mjaft e tensionuar. Protestuesit në ato momente morën gurë, shkopinj, drurë, çfarë kishin për t'iu vërsulur forcave speciale. Unë kam qenë një nga ata 4-5 individë që u kemi dalë përpara protestuesve, duke u kërkuar të mos godasin forcat speciale, sepse nuk ishin ata përgjegjës për ndërtimin e bunkerit dhe për qëllimin që protestuesit i kishin vënë vetes. Pas shumë e shumë përpjekjesh, si të miat, ashtu edhe të disa protestuesve që ishin aty, u arrit të mos kishim një konfrontim me forcat speciale të policisë. Si kompensim edhe i kësaj pune që bëra në atë kohë, kësaj radhe mora një goditje të fortë me shkop hekuri në kokë.

Çfarë ndodhi atë ditë?

Dua të jem transparent dhe të mos fsheh asgjë, qoftë nga incidenti, qoftë edhe nga pozicioni im në bandierën e parë që ishte aty pranë policisë. Gjatë gjithë kohës kam qenë në protestë duke filmuar, duke fotografuar dhe duke bërë punën time, si para Kryeministrit, ashtu edhe gjatë vijimit të protestës në pjesën përpara Ministrit të Brendshme. Në kohën kur protesta po vijonte, te Ministria e Brendshme pati konfrontimet e para të protestuesve me policinë, duke shkatërruar bandierat e hekurta që ishin vendosur aty. Këto bandiera e bënë të pamundur që turma e protestuesve të vijonte rrugën drejt protestës para Ministrit të Brendshme. Ato bandiera u zhvendosën në mënyrë të vazhdueshme herë pas here. Nuk kishte një kordon të qartë policie se ku ishte kufiri i policisë dhe ku ishte ai i protestuesve. Në këtë gjendje kaotike ne, si gazetarë, që ishim aty kemi qëndruar në një podium të gurtë, që ishte pjesa më e lartë e mundshme, ku mund të bëje fotografi dhe të filmoje. Kam bërë shumë fotografi atë ditë dhe kam ndihmuar edhe kolegë të tjerë gazetarë, të cilët nuk arrinin dot të bënin fotografi dhe të filmonin në atë pozicion ku isha unë. Pas një kërkesë që më është bërë nga një prej operatorëve të medieve, jam ulur nga pozicioni ku isha duke bërë filmime dhe ia kam lënë vendin një kamere, e cila mund të filmonte nga ai pozicion. Në këtë moment jam gjendur në krah të gazetarëve nga njëra anë dhe përpara kisha protestuesit. Protesta pati disa episode në ato momente, të cilat nuk bëhen të qarta nga pamjet e pjesshme filmike që transmetohen në medie të caktuara; nuk kemi një incizim dhe një regjistrim të të gjithë situatës, për të kuptuar dinamikën e asaj që ndodhi. Duke qenë në pjesën ku ishin gazetarët, ashtu edhe protestuesit, shpeshherë kordoni i policisë i forcave

speciale shtynte me forcë protestuesit. Protestuesit mundoheshin të rezistonin ndaj këtij reagimi të forcave speciale, megjithatë çdo gjë ishte e qetë deri në momentin kur pati një agresion dhe një dhunë nga këto forca speciale ndaj disa protestuesve.

Dua të kujtoj se rreth 4 minuta para se të ndodhte incidenti, një protestues është goditur me shkopinj gome të hekurt në qafë dhe mbrapa shpinës dhe ka rënë pa ndjenja. Ky protestues ka qenë vetëm 4 metra larg. Emri i tij është Kastriot Hasko. Ju mund ta verifikoni lehtësisht emrin e tij edhe në spitalin “Nënë Tereza”, sepse ka shkuar pa ndjenja dhe atje është përmendur. Pas këtij incidenti të dhunshëm, jemi gjendur në kushtet e vetëmbrojtjes ose të largimit menjëherë nga protesta. Duke qenë se ishte e pamundur, sepse edhe numri i protestuesve ishte shumë i madh, nuk kishe zgjidhje të tjera, veçse të vetëmbroheshe.

Një nga këto zgjidhje është ajo që bëra vetë unë, vendosa të vetëmbrohesha duke vendosur duart te pandiera e hekurt dhe duke mos lejuar precipitimin e mëtejshëm të dhunës, si ndaj pjesës së gazetarëve, ashtu edhe ndaj protestuesve.

Dua t’ju kujtoj, nga fotografitë që keni në rrjetet sociale, janë shumë gazetarë si puna ime që kanë qenë aty, në vijën e parë të frontit. Nuk kam qenë vetëm unë.

Në atë moment nuk e di pse shkopi i gomës, shkopi i hekurt, më zgjodhi mua. Janë pamje të qarta, janë pamje filmike, janë fotografitë që tregojnë se gazetarët kanë qenë në mes të protestuesve, sepse nuk kishte vend tjetër ku të rrinin. Nuk kishte vend të përcaktuar për gazetarët, as një kordon të qartë policie që të vendoste kufirin mes forcave speciale dhe protestuesve.

Në këto kushte është detyrë e gazetarëve të jenë aty ku ndodh lajmi. Pas shoqërimit të zotit Hasko në drejtim të Spitalit Ushtarak, situata është tensionuar dhe ka pasur edhe incidente të tjera. Në këto momente, pasi kam vendosur duart tek bandiera e hekurt, kam tentuar që të mbaj të njëjtat pozicione që kisha, për të mos e ndryshuar rrjedhën e situatës.

Policia, siç duket, kishte marrë urdhër që të vazhdonte të shtynte bandierat përtej atij gardhi që ndodhej dhe në atë moment filloi goditja me shkopinj të hekurt, që mbante në duar policia. Më kanë goditur 4-5 herë, nuk më kujtohet tani mirë. Disa goditje i mora në krahun e majtë të shpatullës, disa në krahun e djathtë dhe ajo që ishte goditja më e rëndë dhe, për mendimin tim do të ishte goditje vdekjeprurëse, në qoftë se do të lëvizte vetëm disa centimetra mbi plagën, që kam aktualisht apo nëse do të prekte shikimin apo syrin, nëse do të ishte më poshtë plagës. Nuk e kam kuptuar për momentin si ndodhi goditja. Kur kam parë pamjet filmike më pas në media të ndryshme, kam arritur të kuptoj se kishim të bënim me një skemë të qartë nga ana e këtyre forcave për të më goditur. Policia apo ai anëtar

i Forcave Speciale, që lëshoi shkopin e hekurt mbi kokën time erdhi nga radha e dytë e forcave të policisë dhe iu krijua një korridor nga pjesa e policëve që ishin në rreshtin e parë.

Erdhi nga pjesa e prapme dhe jo nga pjesa ballore e radhëve të policisë dhe pasi goditi me shkopin e hekurt mbi kokë, ai u tërhoq dhe korridori që ishte vendosur i policëve sërish e mbylli atë, për të mbuluar aktin, për mendimin tim, e dënueshëm dhe barbar nga ana e atij efektivit të Forcave Speciale. Pas këtij momenti, kam pasur një hemorragji shumë të madhe dhe më është dashur ndihma e parë e dy deputetëve të parlamentit, që ndodheshin aty për të neutralizuar çdo lloj përplasjeje, që mund të kishte mes protestuesve dhe Forcave Speciale.

Për fat të mirë kam shkuar në Spitalin e Traumës i shoqëruar nga një urgjencë. Kam pasur një ndërhyrje rreth 40 minuta nga mjekët. I falënderoj ata mjekë që në kushte të vështira kanë bërë një punë të mrekullueshme dhe profesionale, duke neutralizuar edhe problemet e tjera që mund të kisha.

Nuk jam goditur vetëm unë në atë moment, por përveç zoti Hasko ka pasur edhe dy persona të tjerë, të cilët kanë rënë pa ndjenja dhe kanë marrë ndihmën e parë në Spitalin “Nënë Tereza”. Kjo ka qenë panorama e atyre momenteve.

Unë prisja që në radhë të parë të dënohej dhuna ndaj protestuesve. Protestuesit ishin paqësorë dhe unë në radhët e medias nuk kisha asgjë tjetër në dorë veçse një telefoni me të cilin po bëja fotografi. Nëse do të isha i dhunshëm dhe mjetet që do të kisha në dorë do të ishin të dhunshme. Se kush e ushtroi, këtë duhet ta ndjekë drejtësia, megjithëse nuk kam shpresë tek kjo drejtësi.

Drejtori i Policisë, zoti Veliu, më ka vizituar dhe është mirëpritur nga unë dhe njerëzit e mi. E kam konsideruar si një ndërhyrje vizitën e tij, pasi ai më ka thënë se shkopi i gomës nuk shkakton çarje në kokë. Aty kuptova se vizita e zotërisë nuk kishte për qëllim të dënonte dhunën, por manipulimin e së vërtetës dhe në këtë moment pati një acarim mes njerëzve të mi dhe drejtorit të policies, dhe që ndërhyrja e mjekut aty që i shpjegoi atij të vërtetën. Sipas mjekut, plaga ishte shkaktuar nga një mjek i rrumbullakët shumë i fortë, i cili kishte shkaktuar çarjen dhe hemorragjinë, dhe nuk kishim të bënim me një plagë me cepa, por plaga ishte shkaktuar nga ky mjet i fortë.

Pse që i rëndësishëm ky sqarim i mjekut? Sepse kishin dalë disa versione për goditjen time, nga disa media pranë qeverisë sikur isha goditur me gurë. Por nuk isha goditur me gurë dhe këtë sqarim e bënë mjekët në raportin mjekësor, dhe këtë sqarim e bënë më parë se ta bënim ne viktimat. Pas kësaj kanë dalë versionet që kisha dalë si gazetar apo si protestues.

Unë nuk mbaj mend ndonjë protestë që të kem dalë jo si gazetar. Janë të tjerë ata që merren me detyra të tjera, sepse secili ka detyrën e vet.

Unë vërtet jam kryeredaktor i RD-së, që është gazetë opozitare, por nuk i ngatërroj në asnjë moment detyrat si gazetar dhe detyrat partiake, dhe kam qenë, jam dhe mbetem, para se të jem anëtar i një partie, jam një gazetar dhe do të vazhdoj ta kryej këtë detyrë sa kohë që të kem mundësi fizike dhe mendore.

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Kasmi!

Mendoj që ky tregim i dhimbshëm nga ana e një gazetari që ka pothuajse një çerek shekulli eksperiencë profesionale, tregon fytyrën e vërtetë të kësaj qeveria dhe nga detajet që ju na thatë, dhe unë jam dëshmitare e një pjesë të rrugëtimit që ju rrëfyet, tregon se edhe mosdistancimi nga aktet e dhunës së policisë ndaj jush dhe protestuesve të tjerë, sikurse ju na treguat dhe ne jemi dëshmitarë, tregon se urdhëruesit e vërtetë janë Rama dhe ministri i Brendshëm, Xhafaj.

Gjithashtu, si kryetare e komisionit dua të shpreh keqardhjen time më të madhe për ato medie, që në mënyrë absurde thanë se e kishte goditur guri apo një pjesë e deputetëve thanë se kishte goditur rrjetën dhe prandaj u ça e të tjera e të tjera. Pra, shpreh keqardhjen time më të madhe ndaj atyre medieve që, të urdhëruar nga Kryeministri, u munduan të manipulonin ngjarjen. Ndaj edhe ne si deputetë e pamë shumë të rëndësishme që ti të ishe këtu dhe të na tregoje, madje t'i përgjigjeshe edhe pyetjeve të kolegëve të maxhorancës për ato detaje që mund të kenë nevojë për ta zbardhur deri në fund atë që ka ndodhur realisht ditën e protestës.

Urdhëroni, zoti Luan!

Luan Baçi – Kjo seancë e sotme mendoj se ka një rëndësi shumë të madhe, jo vetëm se është goditur një gazetar. Këtu është e tepërt për të folur për rëndësinë që ka media, shtypi i lirë, gazetarët, pasi të gjithë kolegët këtu janë të vetëdijshëm në këtë drejtim, por do të doja të përqendrohesha tek mënyra se si është prezantuar dhe si është paraqitur ky incident i ndodhur në atë protestë.

Zoti Kasmi, çfarëdo lloj pyetje që do të të bëja, do të ishte një pyetje retorike, të cilës do t'ia jepja vetë përgjigjen, për të vetmen arsye se kam qenë vetë dëshmitar, shumë afër teje dhe këtë e them me koshiençë të plotë. Ishte një protestë ku merrnin pjesë mijëra vetë, një turmë që në raste të tilla proteste nuk kontrollohet absolutisht, dhe kolegët përballë e dinë mirë se nuk e kanë kontrolluar fare turmën e tyre nëpër protesta që kanë bërë, por i kanë kaluar të gjitha caqet e mundshme të një proteste.

Duke qenë dëshmitar aty, e kam parë vetë gjithë skenën e ndodhur, herë pas here nga vala e protestuesve, që po vazhdonin të shtynin njëri-tjetrin dhe shumë herë nuk dinin nga shtyheshin dhe nga vinin. Vetë turma shkonte në të gjithë drejtimet.

Unë do t'i jepja përgjigje edhe një pyetjeje tjetër që flitet nëpër rrjetet sociale, ashtu siç thatë ju, zoti Kasmi, se u hoqën barrierat e telave. Ato ishin disa barriera që njëra më ka rënë mua në dorë. Zakonisht, nuk njihem si njeri i dhunshëm dhe kurrë s'kam përdorur dhunë në asnjë lloj situatë, por ja që ajo barrierë teli ra dhe mund të binin me dhjetëra barriera, ashtu siç ranë mbi gjithë ato mijëra njerëz, që shtyheshin me njëri-tjetrin.

Zoti Kasmi, unë e kam parë vetë skenën se si shtyheshin në ato momente të mbajtjes te telat. Kam qenë shumë afër aty me disa kolegë të tjerë dhe e kam parë vetë policin që ka dalë, duke mos e pasur të domosdoshme fare. Ai zotëria në fjalë që të rrinte se ishte i mbrojtur pas atyre barrierave të telave, ka dalë nga krahu tjetër dhe ka e ka goditur fort, jo një herë, por di s'ke parë disa shkopinj gome, se unë kam qenë shumë më larg nga ty, për të qenë i sigurt, dhe shkopi i gomës ka kapur edhe koka të tjera dhe trupa të tjerë njerëzish.

I them këto për t'i kursyer edhe kolegëve të pozitës, se jam i sigurt se do të drejtojnë pyetje nga më të ndryshmet dhe do të bëjnë avokatin e policisë. Unë do të dëshiroja nga kolegët e pozitës, që për herë të parë sot, duhet që të gjithë bashkërisht të dënojmë dhunën e ushtruar ndaj gazetarit dhe mos ta paraqesim gazetarin Bledi Kasmi, meqë është gazetar i RD-së, po është e vërtetë, por, në fund, ai është një gazetar profesionist, i cili ndodhej aty për të pasqyruar me vërtetësi protestën, sepse, më duhet ta them edhe këtë, shumë medie të tjera i kanë bërë protestës një pasqyrimin të deformuar në të gjitha drejtimet, për arsye që i dinë vetë ato medie. Kështu, një gazetar i "Rilindjes Demokratike" do të bënte një pasqyrim shumë herë më objektiv dhe realist të protestës.

Kjo ishte arsyeja se përse Bledi Kasmi ndodhej në mes të turmës. Kjo ishte arsyeja pse Bledi Kasmi ndodhej me një telefon në dorë, për të filmuar, fotografuar e pasqyruar me vërtetësi protestën. Pastaj ndodhi ajo që ndodhi.

Unë do të doja që sot, të gjithë së bashku, sinqerisht, ta dënojmë këtë dhunë, e pse jo, edhe t'i kërkojmë Policisë së Rendit, drejtuesve të policisë, gjetjen e atij punonjësit të policisë, i cili, në mënyrë të qëllimshme dhe plotësisht të ndërgjegjshme, ka dalë nga barriera e telit dhe ka goditur mbi turmën e mbi gazetarin Bledi Kasmi.

Zoti Kasmi, t'u bë një pyetje, se përse shkopi i gomës erdhi e ju gjeti pikërisht juve? Pikërisht sepse ishte kryeredaktori i gazetës "Rilindja Demokratike". Kjo ishte arsyeja, ky

ishte mllëfi i atyre punonjësve të policisë aty, të cilët u morën vetëm me ty në atë drejtim, duke të goditur me shkop gome ty dhe shumë protestues të tjerë.

Nuk kam çfarë të shtoj tjetër. Unë do të të uroja shërim të shpejtë e përfundimtar, zoti Kasmi! Të jesh i sigurtë se të gjithë jemi me ty.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Fjalën e ka Luçiano, pastaj Musai. Me radhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbas Luçianos, po. Me radhë.

Ju lutem, kemi pyetje.

Luçiano Boçi – në fakt, përtej fjalëve, përtej shpjegimeve, përtej hipotezave, ajo manikota në kokën tuaj tregon më së miri jo thjesht gjendjen fizike, pas dhunës të ushtruar nga policia mbi një gazetar, por tregon qartë gjendjen në të cilën ndodhet sot media, media e lirë dhe media e vërtetë.

Në qoftë se u referohemi jo vetëm ngjarjeve që kanë ndodhur në Shqipëri përgjatë këtyre pesë vjetëve, duke u nisur nga sjelljen e Kryeministrit me mediet, duke vazhduar me sjelljen e policisë, duke vazhduar me sjelljen e ish-ministrave, të cilët i kemi edhe këtu, në qoftë se u referohemi dhe raporteve ndërkombëtare për lirinë e medieve, në mos gaboj, 3 maji ka qenë dita e lirisë së medias, Shqipëria ka njohur vetëm zbritje në klasifikimin e lirisë dhe ka humbur shumë parametra të lirisë së medias. Kjo është një betejë që pushteti ia ka shpallur hapur medieve, e që në një farë forme, deri më tani pothuajse e ka fituar, pasi disa medie i ka kapur me interesa, disa i ka kapur me dhunë, disa të tjera i kontrollon nëpërmjet fijeve të saj. Pozita më e vështirë sot është pozita e gazetarit që punon në një medie, jo vetëm në një medie të kontrolluar e të censuruar, por sidomos në një medie të lirë e të vërtetë.

Në fakt, unë jam i trishtuar për faktin se në këtë komision, që prej shumë vitesh, ne flasim për një binom të instaluar në marrëdhëniet me shoqërinë shqiptare, flasim për binomin polici-medie. Po ta shohësh, ky lloj binomi nuk ekziston në botën perëndimore, në botën e qytetëruar, atje ku duam të integrohemi. Nuk është folur asnjëherë dhe nuk mund të flitet se ka një marrëdhënie kundërshtie e përplasjeje midis medias dhe policisë. Të paktën sipas informacioneve që unë kam, nuk më ka qëlluar ta has në lajme, në kronika apo në forma e mënyra të tjera. Sigurisht, përtej Europës ka edhe ekzekutime gazetarësh, ka edhe qëndrime të tjera, por edhe këtu te ne, mënyrat e ekzekutimit të fjalës së lirë ekzistojnë dhe realizohen. E thashë se që prej pesë vitesh që ne, në këtë komision, kemi diskutuar shpesh në lidhje me

mënyrën se si është sjellë policia, në lidhje me mënyrën se si është sjellë Kryeministri me medien. Është absurde një situatë e tillë. E kam thënë edhe herë të tjera në këtë komision: ka qenë policia, forcat e rendit, drejtuesit e policisë ata që kërcënuan Denis Kuqin, i cili vetëm pas pesë vjetësh u largua nga Shqipëria. Kanë qenë forcat e gardës, forcat e policisë, ata afër Kryeministrit, që kërcënuan Hamza Dikën. Kanë qenë po këto forca, ato që detyruan Gerti Xhajën të largohet sot nga Shqipëria. Ka qenë vetë Kryeministri ai që ka dhunuar verbalisht, ai që ka telefonuar, ka kërcënuar gazetarë, drejtorë, pronarë mediesh, me qëllim që të ndryshojnë vijën editoriale të lajmeve të gazetave, të emisioneve televizive. Në fakt, kemi pesë vjet që e përjetojmë dhe e bëjmë këtë luftë në komision. Përgjatë këtyre pesë vjetëve, ky binom jo vetëm nuk është zhdukur, por është forcuar në marrëdhënie kundërshtuese. Rastin më flagrant, më të shfaqur në publik, sepse gjërat e tjera janë të pashfaqura, censura e autocensura duket sikur nuk transmetohen, megjithëse ekzistojnë në mënyrë absolute. E thatë edhe ju mënyrën se si u pasqyrua protesta në mediet e tjera. Ajo dhuna fizike është pasqyruar në rastin konkret tuajin.

Po thosha se përderisa ajo manikota është simbol, simboli ka edhe kuptimin. Shtrati është më i gjerë se simboli. Se ne e dimë shumë mirë, jemi të ndërgjegjshëm: nuk mund të flitet dhe nuk mund të themi me gojën plot se kemi liri mediesh. Jo, nuk kemi! Kemi gazetarë të lirë, kjo është e vërtetë, kemi gazetarë që tentojnë ta thonë fjalën e tyre, tentojnë ta shprehin fjalën e tyre, por që pësojnë dhunën e pushtetit. Përndryshe nuk do të ishte shkarkuar Aida Tota, përndryshe gazetarët e “Publicus” nuk do të ishin larguar dhe emisioni nuk do të qe mbyllur; përndryshe Jetmir Olldashi nuk do të ishte sot s’dihet se ku, ngase është kërcënuar dhe survejuar nga policia. Kjo është sjellje tipike që ka policia sot, e cila nuk është më Policia e Shtetit, të them të drejtën, nuk është policia e qytetarit, por është shpërfytyruar tërësisht: kjo është policia politike e Ramës. E them këtë, ngaqë arriti të godasë gazetarët jo vetëm te protestuesit, por madje ka kurajën të vërë në survejim e në përgjim edhe kryetarin e opozitës.

Dua të bëj lidhjen se përse po i referohem këtij rasti. Po i referohem, sepse lajmi ka dalë nga një medie serioze dhe nuk është konsideruar sepse është krijim gazetaresk. Jo. gazetaria synon të kapë të vërtetën dhe ta transmetojë atë në shoqëri dhe ky është një rast i vërtetë. Forcat operationale janë përdorur si forca private. Kjo jo vetëm në rastin e survejimit të kryetarit të Partisë Demokratike. Jo! Janë përdorur edhe në raste të tjera, por është ajo historia, këtu do të jemi dhe do të dalin faktet. Janë përdorur në operatione shumë të rëndësishme. Janë përdorur si të jenë pjesë e aneksit të ministrit X apo të drejtorit të policisë

X, kjo është e vërteta, siç janë përdorur në survejimin e kryetarit të opozitës. Nuk është çudi që sot, shumë agjentë të policisë përdoren në mënyrë private për të survejuar dëshmitarë, për të survejuar mediet, për të survejuar edhe gazetarë të caktuar, sepse atij policit që goditi gazetarin nuk i ra bingo. Jo. Mos e mendoni se ishte rastësi, rastësi e keqe apo rastësi e bukur, gjë që varet nga interpretimi. Jo, jo, ishte i urdhëruar, gazetari ishte i përndjekur, ishte i targetuar dhe u kap me qëllim nga goditja, sepse ishte goditje e orientuar.

Kjo policia jonë e famshme, që sot është shpërfytyruar plotësisht, nuk heziton fare të dhunojë edhe qytetarët e thjeshtë, sepse medien e ka në ekzistencën e saj, e ka marrë si mision, e mbulon, por të godasë edhe qytetarët e thjeshtë, siç ndodhi në Elbasan, në protestën që të rinjtë e forumit rinor të Partisë Demokratike organizuan. Kam qenë vetë prezent. Është dashur ndërhyrja e autoritetit të deputetit, është e tmerrshme, që të ndalojë policinë të veprojë ndaj disa të rinjve që kishin pankarta në duar, të cilat polici ende s'i kish lexuar, sepse në to mund të qe shkruar: "Mirë se erdhe, Kryeministër!", megjithëse, në fakt ishin: "Mirë se erdhe, pasha i drogës!". Sepse, me të vërtetë që mafia ka ofiqet e veta: pasha, vezir. Janë miklime, janë përkëdhelje që përdoren. Ishte një dhunë e hapur në mes të qytetit, pa asnjë tagër policor, pa asnjë detyrim nga detyra, por detyrime të ardhura me urdhra nga lart për pengimin e një proteste. Aq sa, bashkë me policinë, në mënyrën më absurde, meqë janë mediet, u bashkuan edhe forcat speciale "Shqiponjat", të cilat nuk e kanë në protokollin e tyre shoqërimin e Kryeministrit, përveç rasteve të një kriminaliteti të lartë. Në fakt, Elbasani ka kriminalitet shumë të lartë, kjo dihet, por flenë gjumë edhe policia, edhe forcat speciale.

U turrën të armatosur. Ishin të gjithë të armatosur, i kam fotot e tyre dhe do t'i publikoj, për të ndaluar të rinjtë e forumit rinor, që ishin të moshave nga 20 deri në 25 vjeç, me pankarta në duar, jo të dhunshëm, por që e shprehnin revoltën e tyre në format më qytetare të mundshme.

Pra, kjo është ajo pjesa e shpërfytyrimit të policisë. Kjo është arsyeja që diskutojmë sot se përse kemi një binom polici-media, pse policia është e ndërsyer ndaj medias. Kjo sepse Kryeministri është orientuesi kryesor. Është sjellja e Kryeministrit, e ministrave, ish-ministrave ndaj medias, ndaj medias që thotë fjalën e vërtetë. Sepse, sigurisht, media ka problemet e saj. E kanë thënë: në Shqipëri problemi është shumë gjigant, në pjesën e tyre më të madhe mediet janë të kapura. Lajmi transformohet, transmetohet jo i plotë, pritët ose keqinterpretohet. Këto gjëra dihen dhe janë shqetësim, por ndonjëherë janë gjëra që u mungon konkretësia dhe në komisionin tonë i kemi ngritur shpesh, por kemi hasur edhe në neglizhencën e kolegëve tanë të maxhorancës. Ndërsa rasti yt konkret është rast ulëritës, në

fakt, që duhet të angazhojë tërë opinionin mediatik shqiptar, por edhe opinionin publik, sikurse vetë politikën, që të mbajë ato qëndrime që i takojnë, në përputhje me moralin e saj dhe moralin e demokracisë, e cila ndjehet e goditur në Shqipëri dhe po përjeton një nga fazat më të vështira të ekzistencës së saj, kur një ndër kolonat themelore, të mos themi më themelorja, siç është liria e medias, është tërësisht e goditur. Unë besoj se do të duhen vite që kjo medie e lirë, kjo liri e medias të rishfaqet edhe një herë në ato përmasa që ne e kërkojmë. Duhet vite për ta bërë një gjë të tillë.

Në qoftë se unë do të vazhdoja me rolin dhe shpërfytyrimin e policisë, do të dilja te përshëndetja që kolegja ime bëri në fillim. Në fakt, edhe unë doja t'u uroja maturantëve shumë suksese, doja të bëhesha solidar me ta, pasi, duke ardhur nga fusha e arsimit e di shumë mirë se një maturan nuk mund ta mësojë një lëndë për tri ditë, por do të kemi kohë të bëjmë edhe vërejtjet tona, sepse ia kanë ngjeshur aq shumë maturantëve të vegjël ato provime, sa nuk e di si do ta përballojnë sezonin e provimeve. Ndërsa atë punën e policisë, që policia do të dalë e të mbrojë maturantët, unë nuk e kuptoj fare se përse policia duhet t'i mbrojë maturantët, kur shkollat kanë të gjitha mënyrat, kanë të gjitha mjetet, kanë të gjitha procedurat për të kontrolluar provimin, për të marrë një rezultat që është afër objektivitetit për maturantët. Nuk ka arsye që policia të jetë kaq entuziaste; kur organizohet për provimin e matures, duhet të jetë entuziaste...

Adelina Rista – Nuk të lejohet të abuzosh, Luçiano!

Luçiano Boçi – Nuk duhet të jetë kaq entuziaste...

Adelina Rista – Mos abuzo!

Luçiano Boçi – Adelina, nuk po abuzoj.

Adelina Rista – Mbrohen qendrat e kontrollit të provimeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Policia nuk duhet të jetë entuziaste as kur godet gazetarët dhe as kur në fjalën e tij drejtori, kryepolici, siç e tha gazetari, deklaroi me pompozitet që shkopi i gomës nuk ta çan kokën. Normal, harroi se policët e tij i kishte të pajisur edhe me mjete të tjera. Po ashtu, nuk duhet të jetë kaq entuziaste kur godet të rinjtë e forumit rinor. Nuk duhet të jetë kaq entuziaste kur godet protestuesit. Se sa bukur këtu: qenka goditur gazetari, janë goditur edhe protestuesit dhe qenka normale që janë goditur protestuesit! Ky është alarm. Alarmi më i madh është gazetari. Po protestuesit, pse duhet të goditen? Cila është arsyeja? Pse janë qytetarë dhe kërkojnë demokraci në këtë vend? Kjo është arsyeja? Pra, jemi në një gjendje alarmi.

Përderisa ne jemi këtu edhe si mesazherë të së vërtetës, sikurse është gazetari në funksionin e tij, por edhe ne si deputetë, duhet të mbrojmë të vërtetën, pavarësisht përkatësisë politike. Kjo është e vërteta. Kjo është gjendja në të cilën ndodhet media. Ne jemi të parët që na takon jo vetëm të ngremë zërin, jo vetëm të ndërmarrim veprime thjesht me seanca dëgjimore, por të shohim në thellësi se cila është gjendja e medias dhe e gazetarëve sot, që në të vërtetë është alarmante.

Prandaj, të dashur kolegë të maxhorancës, do t'ju ftoja të dalim në një qëndrim për dënimin e dhunës, sepse dhuna nuk na çon asgjëkundi. As nuk çel negociata, as nuk ndërton demokracinë, as nuk promovon të vërtetën dhe vlerat qytetare. Përkundrazi, ka efekte të kundërta. Pushteti mund të jetë i ëmbël, por nuk mund të ruhet ëmbëlsia e pushtetit tuaj me hidhësinë e dhunës policore ndaj medias, ndaj shoqërisë, ndaj drejtuesit të opozitës, ndaj gazetarëve, ndaj dëshmitarëve që thonë të vërtetën, përndryshe ky vend do të degradojë gjithnjë e më shumë në sajë të degradimit qeveritar, që po e realizoni ju sot.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Përpara se t'ia kaloj fjalën zotit Ylli, unë kam këtu deklaratën dhe do të të kërkoja ta firmosje sot...

Fidel Ylli – Të mbarojmë njëherë, sepse njerëzit duan të dinë si është e vërteta. Boll tani me konferenca shtypi!

Albana Vokshi – Mos më ndërhy, sepse...

Fidel Ylli – Të lutem, na lër të flasim! Keni gjysmë orë që po bëni konferenca.

Albana Vokshi - Kur të të vijë radha do të flasësh, mos bëj zhurmuesin!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Pse, ti do të na komandosh? T'u japësh gjithë anëtarëve të tu...

Albana Vokshi - Po, unë e komandoj...

Fidel Ylli - Njerëzit duan të dinë për ne. Ju e keni thirrur gazetarin, na lini ne...

Luan Baçi – Fidel, është kryetarja e Komsionit ajo.

Fidel Ylli - Opinioni publik do të dijë se çfarë mendon maxhoranca për këtë...

Albana Vokshi – Qetësohu! Mos më bërtit mua!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ke asnjë të drejtë të më bërtasësh mua!

Fidel Ylli – Boll tani me ato deklarata! Firmoseni ju...

Albana Vokshi – Ule zërin!

Fidel Ylli - Po lëre tani, se nuk më tremb dot! Vazhdo tani!

Albana Vokshi – Kjo deklaratë, e firmosur nga deputetët e opozitës, i është dërguar Presidentit të Republikës...

Fidel Ylli – Dakord. Firmoseni! Shumë mire!

Ne dënojmë dhunën për të dyja palët, jo vetëm për njërin palë.

Albana Vokshi – Prit, se do të ta jap fjalën, mos ndërhy!

...I është dërguar Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, delegacionit të Bashkimit European dhe të gjitha vendeve anëtarë të Bashkimit European në Tiranë.

Distancohuni edhe ju nga dhuna. E ka thënë Johanes Han: “Liria e shtypit dhe e medias është prerogativë”, është kusht për hapjen e negociatave.

Keni 24 ditë kohë. Ju lutem, këshillojeni Kryeministrin të ulët me këmbë në tokë dhe të fillojë të plotësojë një nga një kriteret...

Fidel Ylli – Mbarove?

Albana Vokshi- ...të mos ushtrojë dhunë, të mos mbyllë portalet, të mos censurojë portalet! Ju lutem, distancohuni nga dhuna!

Fidel Ylli – Do të na e japësh të drejtën për të folur?

Albana Vokshi – Më vjen mirë që keni ardhur të përgatitur sot. Ja, ku e keni.

Fidel Ylli – Tani, na dëgjo edhe ne.

Albana Vokshi – Është për turp kjo që bëni!

Vazhdo!

Ju e keni fjalën.

Fidel Ylli – Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk është hera e parë që ky komision mbledhet për protesta, për problemet me gazetarët, pasi më 21 janar, ju e dini, qeveria e asaj kohe, Sali Berisha, shpalli puçistë 4 gazetarë, të cilët po bënin detyrën e tyre në katin e katërt të godinës në bulevard, pa pasur konfrontime me policinë dhe, përveçse i shpalli puçistë dhe i thirri në Komision, arriti të hynte në lokal dhe i nxori me dhunë gazetarët.

Albana Vokshi – Akoma e ka fajin Saliu?! Flit për dhunën tani! Po si nuk ju vjen turp?! 5 vjet në pushtet dhe thoni: “E ka fajin Saliu”? Është turp i madh!

Fidel Ylli – Të lutem!

(Debate pa mikrofon.)

Mua nuk ma mbyll dot gojën!

(Debate pa mikrofon.)

Luçiano Boçi - Ju i latë njerëzit atje...

Albana Vokshi – Distancohuni nga dhuna!

(Debate pa mikrofon.)

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli - Të lutem, Vilma!

Albana Vokshi – I ra gurit me kokë, këtë do të thuash?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – E di pse e nisa me protestën?

(Debate pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Mos bojkotoni, rrini këtu! Mos merrni urdhra...

(Debate pa mikrofon.)

Do të flasë Fideli.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Kjo është dhuna që i bëni ju, si opozitë, maxhorancës në komision.

Unë ju dëgjova për 40 minuta me shumë vëmendje, që nga Luani, zoti Boçi... Të gjithë folët dhe unë nuk ndërhyra fare. E dëgjova me shumë vëmendje edhe gazetarin. I uroj shërim të shpejtë!

Duhet ta dish, Albana, kam pasur një lokal, që quhej bar “West”, ku rrinin të gjithë gazetarët e Shqipërisë dhe jepnin lajmin. Jam i lidhur me gazetarët, i respektoj maksimalisht ata. Pse e nisa me 21 janarin? Jo thjesht për të kujtuar Saliun e parë apo Saliun e dytë, por në të njëjtën kohë që qeveria e asaj kohe thërriti në Komision 4 gazetarë të quajtur puçistë, në kohën kur po bënin detyrën lart, në lokal, gazetari....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...në fjalë, te gazeta “Rilindja Demokratike”, shikojeni se çfarë shkruan:

Luan Baçi – Te cili lokal?

Fidel Ylli – ...“Dështojnë puçistët”. Shikojeni pra, kryeredaktori i gazetës!

(Debate pa mikrofon.)

Do t’ju sqaroj unë sot, se nuk ma mbyllni dot gojën.

Gazetari juaj nuk është gazetar. Ju doni të bëni zhurmë...

(Debate pa mikrofon.)

Mbylle gojën dhe rri urtë, se me mua e ke të humbur bisedën!

(Debate pa mikrofon.)

Të dëgjova me vëmendjen. Nuk të ndërpreva.

(Debate pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Është për ty ajo.

(Debate pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ma jep, se do ta nxjerr unë: “Ka dështuar puçi i 21 janarit”. Bravo ju qoftë që tregoni medien e lirë!

Fidel Ylli – Gazetar i qeverisë.

I kujt është? Është gazetar i lirë?! Çfarë është ai?

Albana Vokshi - Edi Rama kishte organizuar puç më 21 janar.

Fidel Ylli – Ai shkruan me urdhër të Sali Berishës... Vetëm gazetar nuk është ai!

Mos u mërzit, mbaje, se kam kopje tjetër!

Albana Vokshi – Kush jua ka dhënë këtë, bravo i qoftë, se ja ku e ke medien e lirë, që ka raportuar të vërtetën e 21 janarit!

Fidel Ylli – Mos u shqetëso! Jemi duke folur për medien e lirë...

Albana Vokshi - Pikërisht.

Fidel Ylli – ...dhe gazetarin e lirë, që kolegët e vet i quan puçistë.

Albana Vokshi – Medien e lirë, siç duhet të raportonte 21 janarin.

Trego protestën e fundit dhe dhunën!

(Debate pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Urdhëroni! Ja, ku i keni shkrimet.

(Debate pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Këta bien vetë me këmbët e veta.

Kush ta ka thënë këtë?

Fidel Ylli – Më lër ta mbaroj! “Pucistët”, e shkruan ai.

Albana Vokshi – Është për Edi Ramën.

Fidel Ylli – Ma ka dhënë Bledi Kasmi. Është “RD”-ja. Është gazeta e kryeredaktorit të “RD”-së.

(Debate pa mikrofon.)

Më dëgjo këtu! Më lër të mbaroj!

Luan Baçi – Zoti Ylli, vetëm një sekondë.

Fidel Ylli – Urdhëro!

(Debate pa mikrofon.)

Luan Baçi – Të lutem, zonja Vokshi!

Albana Vokshi – Po prit, se e ka ky radhën...

Luan Baçi – Ma dha të drejtën.

Albana Vokshi – Nuk ta jep ai, ta jap unë fjalën. Të lutem, tani!

Lëre, se po nxjerr xhevahire!

Luan Baçi – Zoti Ylli, do të të bëj edhe një pyetje të vogël.

Fidel Ylli – Sa të duash.

Luan Baçi – Përse nuk diskutojmë për atë që jemi mbledhur sot, për incidentin e dhunshëm ndaj zotit Kasmi dhe...?

(Debate pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Për këtë po mblidhemi, se ma latë përgjysmë fjalën. Thashë se atëherë jemi mbledhur për këta gazetarë të quajtur puçistë, kurse sot jemi mbledhur për një person, që bëhet viktimë dhe viktimizohet këtu në komision.

(Debate pa mikrofon.)

Shikoje çfarë rrëmuje bën! Vetëm gazetar nuk është ky!

Luan Baçi – Ai është gazetar, se ka qenë me telefon në dorë dhe kam qenë vet prezent.

Fidel Ylli – Ku e ka telefonin? Shikoje, shikoje!

Luan Baçi – I ra telefoni te turma. Kam qenë vetë aty. Ai është gazetar, absolutisht.

Fidel Ylli – Ai vetëm gazetar nuk është. Ai është agresor. Ta lëmë këtë *show* këtu. Të shkojë në prokurori, të gjejë atë që i ka rënë në kokë dhe të vazhdojmë...

Luan Baçi – Gjejeni ju atë, se i ka rënë polici.

Fidel Ylli – Shikoje! Çfarë është ky? Gazetar?!

Luan Baçi – Isha aty, mos ma trego me kamera.

(Debate pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Jeni të admirueshëm sot! Paskeni ardhur të përgatitur, ashtu sikurse i keni qepur të zyra e Endri Fugës... Ju lumtë! Bravo ju qoftë! Na jepni prapë si këto.

Fidel Ylli – Tani, do të na lësh të mbarojmë?

Albana Vokshi – Ju lutem, se tregoni manipulimin që u bëni zyrave! E keni fantastik fare! Kam qenë edhe unë aty, Musa, ta tregoj edhe unë.

(Debate pa mikrofon.)

Vazhdo, të lutem!

Ju sot qenkeni për t'u përshëndetur.

(Debate pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Më lër të mbaroj!

Albana Vokshi - Vazhdo, Fidel, se sot qenke plot me xhevahire!

Fidel Ylli – Më lër të mbaroj! Folët një orë, nuk ju ndërpreva.

Albana Vokshi – Mos repliko, por vazhdo!

Fidel Ylli – Më lini të mbaroj, sepse të gjitha këto...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – E ka kolegu yt.

Fidel Ylli – O Adelina...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Kam gjysmë ore që po i them të vazhdojë dhe të mos replikojë.

Nuk do, do të replikojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Me kë po replikoj? Unë po flas...

Albana Vokshi – Po replikon me kolegët.

Fidel Ylli – Juve nuk ju vjen mirë që keni futur gazetarë në burg, Martin Leka, Sandër Frangaj... Keni vrarë... Fatos Mahmutajn e keni me azil në Belgjikë. Iu shpua dora në tavolinën e punës në bulevard.

E kuptoni apo s'ë kuptoni se çfarë jeni ju?! Ju jeni vrasës. Flisni ju për gazetarët!

Luçiano Boçi – Mbylle atë gojë ti! Kë akuzon si vrasës ti?

Fidel Ylli – Vratë 4 të pafajshëm.

(Debate pa mikrofon.)

...Halabak!

Luçiano Boçi – Halabak je ti!

Fidel Ylli - ...Nuk të llogaris fare unë ty.

Luçiano Boçi – Halabak je ti! Legen!

Fidel Ylli - Kujt i thua legen ti, mua?!

Luçiano Boçi – Po ti, kujt i thua vrasës?!

Fidel Ylli – E di çfarë je ti? Një fluskë sapuni je!

Luçiano Boçi – Ec, ore, legen, vazhdo aty!

Fidel Ylli – Ec, ore, lëngaraq!

Luçiano Boçi – Lëngaraq je ti!

Fidel Ylli – U bëre ti, të më ndërpresësh fjalën mua!

Luçiano Boçi – Mbylle gojën!

Fidel Ylli – Mbylle ti gojën!

Kujt i thua mbylle gojën ti, more?

4 vrasje ka bërë qeveria jote.

Luçiano Boçi – Ti ke qenë organizator, ke vënë edhe mjete financiare në dispozicion...

(Debate pa mikrofon.)

Gazetarë keni vrarë ju!

(Debate pa mikrofon.)

Fidel Ylli - Legen je ti! Lëngaraq, halabak, rrugaç ordiner! Rrugaç, që ua pret fjalën kolegëve këtu! Nuk të shpëton kjo ty.

(Debate pa mikrofon.)

Mbylle, se po flas unë!

Do të flas si dua unë, jo si do ti. Keni vrarë 4 vetë në bulevard.

(Debate pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Jam unë me mikrofon.

Fidel Ylli – Po, po, me mikrofon ti! E kam unë të drejtën të flas. Si të dua unë do të flas, jo si do ti!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Luçiano, të lutem, tani!

Fidel Ylli – Këto që po ju nxjerr këtu, janë shkrimet e këtij gazetari.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vetëm gazetar i lirë nuk është ky, që vjen në komision dhe viktimizohet!

(Debate pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Kujt i bëni teatër këtu?! Çfarë kujtoni ju?! Ku e gjeni këtë arrogancë?! Mos bërtisni! Çfarë jeni ju?! Thoni më mirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ofendime, ky...

(Debate pa mikrofon.)

O Fadil, kujt po i bërtisni ju?!

Fidel Ylli – I mohon ti 4 të vrarë në bulevard?

Albana Vokshi – Ju, që bërtisni, çfarë kujtoni?! Kë shantazhoni ju?! Nuk na shantazhoni dot. Nuk e keni kuptuar këtë?

Uleni zërin! Mos bëni arrogantin! Mos kërcënoni!

(Debate pa mikrofon.)

Me arrogancë nuk ecet në këtë komision. E kuptoni apo jo? Uleni zërin dhe mos bërtisni!

(Debate pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Të dëgjova 40 minuta, nuk të ndërpreva fare.

Albana Vokshi - Pse nuk reagove kur tha ky: “Vrasës”?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli - Pse më ndërpret?

Çfarë i bëra? Foli 40 minuta dhe nuk e ndërpreva fare. Foli çfarë deshi.

Albana Vokshi – Do të flasësh apo të ta heq fjalën?

Fidel Ylli – Nuk ma heq dot fjalën!

Albana Vokshi - Ta heq që çke me të!

Fidel Ylli – Në botë nuk ma heq dot! Jo ti, po as Zoti nuk ma heq dot fjalën!

Albana Vokshi – Ki kujdes me ato që flet...

Fidel Ylli – Rri tani, mos më trego kujdesin mua! Drejtoje mirë mbledhjen!

Albana Vokshi – Vrasës është ai atje, përballë...

Fidel Ylli – 4 njerëz ka vrarë qeveria juaj...

Albana Vokshi – Ai i ka vrarë të katërt. Shko dhe gjeji atje! I ka vrarë ai.

Fidel Ylli – ...me armë. U dënuan njerëz për ato vrasje, dakord?

Albana Vokshi – Ju i nxorët nga shtëpia...

Fidel Ylli – Po ai tha: “Unë do të kaloj mbi trupa njerëzish”, një natë më përpara.

Po gazetari? 4 vetë të vrarë dhe ke njerëz të dënuar.

Albana Vokshi - Ja ku e ke vrasësin, atje e ke, ai i solli, ju i sollët, ju e dirigjuat puçin.

Fidel Ylli – Po gazetarin kush e solli?

Albana Vokshi - Kërkojuni ndjesë atyre që keni vrarë! Kërkoji ndjesë ti sot dhe ai që është përballë! Ai është vrasës. Kërkojuni falje atyre, mos hajde këtu të na thuash vrasës. Ju që jeni këtu, keni shkuar derë më derë dhe i keni nxjerrë njerëzit duke i mashtruar.

Fidel Ylli – Garda e Republikës vrau 4 vetë.

Albana Vokshi – A do të flasësh apo të ta heq fjalën? Lëri këto, por fol për dhunën.

Fidel Ylli – Për këtë dua të flas, por ju nuk me lini, se ju djeg.

Albana Vokshi – Neve na djeg? Ju sot qenkeni shumë rëndë dhe po e tregoni me fytyrje dhe shantazhin ndaj opozitës sa rëndë e sa keq jeni. Po ju rrëshqet pushteti nga këmbët.

Ti, Fidel Ylli, nuk vjen dot në këtë komision që të na shantazhosh, ti nuk na fyen dot, as ti e as kolegët e tu nuk na thoni dot vrasës.

Fyerja nuk është argument.

Fidel Ylli – 4 vetë i vrau qeveria nëpërmjet Gardës së Republikës.

Albana Vokshi – I ke vrarë ti me ata që i mashtruat.

A do të flasësh apo t'ia kaloj fjalën dikujt tjetër? Fol, por mos fyej, se unë ta heq fjalën!

Fidel Ylli – Mos më trego fyerjen ti mua dhe fjalën nuk ma heq dot.

Albana Vokshi – Fol për dhunën që ushtuat me urdhër dhe të targetuar, me urdhër të Ramës dhe Xhafajt.

Fidel Ylli – Atë desha të them, por ti nuk të lë. Ti duhet të dish një gjë, që fjalët e mia më të pista janë “më fal” dhe “të lutem”. Unë nuk fyej kurrë, por të më thotë mua “halabak” ai kolegu yt....

Albana Vokshi – A do të flasësh apo të ta heq fjalën?

Fidel Ylli – Po, do të flas, se fjalën nuk ma heq dot, se unë kam fakte. Vjen një gazetar për të bërë viktimën, se mua me vjen keq për atë.

Albana Vokshi – Po si nuk të vjen turp, se kam qenë vetë në spital me të?!

Distancohu një herë të vetme!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk mbaron ai, e ka detyrë, ia kanë dhënë si detyrë, se është sportist.

Fidel Ylli – Nuk ke shans me mua për asgjë. Lëre tani, je shumë larg ti! Ku ka të fortë këtu? Nuk ka të fortë sot, iku koha e forcës, fare.

Albana Vokshi – Nuk e bën dot të fortin tani, Fidel. A do të flasësh apo t'ia jap fjalën Mondit? Ky e ka detyrë nga Rama që të bëjë zhurmuesin sot. Nuk po e kuptoni? Vazhdojmë me rendin e ditës!

Fidel Ylli – Rri aty, se nuk ke të drejtë ti të më heqësh fjalën. Fole 40 minuta dhe nuk të ndërpreva.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – O Mondit, ai këtë urdhër ka.

Kolegë të maxhorancës, hiqni dorë nga plani për të sabotuar këtë mbledhje dhe na lini të vazhdojmë me rendin e ditës!

Sado që të përpiqesh Fidel, nuk do ta shmangësh vëmendjen; çfarëdo urdhri të kesh marrë nga zyra përballë, nuk do ta shmangësh vëmendjen e këtij komisioni. Kemi ardhur për

të folur për dhunën ndaj kryeredaktorit të gazetës më të madhe opozitare, prandaj na lër te rendi i ditës! Nëse do, thirr seancë tjetër!

Fidel Ylli – Nuk kam mbaruar akoma, ta mbaroj fjalën unë, pastaj. Ju ma pretë në mes dhe unë ju sqarova që e gjithë rezymeja që bëra...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po nuk po më lë! Pra, e gjithë rezymeja që bëra dhe ju solla disa fakte, lidhet me personin në fjalë. Unë nuk bëra rezyme që të kthehesha në '92-shin apo në '93-shin, por personi në fjalë është ky që sot viktimizohet, krijon dhunë, nuk bën detyrën e gazetarit si gjithë të tjerët, pra që të filmojë dhe të fotografojë, por shkon shkull hekura dhe godet policinë. Unë këtë them, që në një rast kur gazetarët bënin detyrën e tyre, duke ndenjur atje, shkruanin dhe u quajtën “puçistë”, ne i thërrasim në komision, kurse sot thërrasim një njeri që viktimizohet për të qenë viktimë e dhunës së policisë, në një kohë që ai dhunon fjalën e lirë, shkruan për kolegët e vet dhe i quan “puçistë”. Ju flisni çfarë të doni, por ai quan puçist Andi Bushatin, Mero Bazen që bëjnë opozitë, u thotë të gjithë gazetarëve që bëjnë opozitë.

Albana Vokshi – Bledi, na sqaro pak këtë punën e puçistëve! A ke ushtruar dhunë? Na e sqaro edhe njëherë pse u ndodhe të gardhi dhe pse këta na tregojnë video të manipuluar. Unë kam qenë vetë atje, por nuk dua të dalë nga goja ime. A ke ushtruar dhunë ndaj policëve?

Bledi Kasmi – Të sqaroj atë punën e gazetës së datës 22 janar, që ka titullin “Dështim i puçistëve”. Ai titull ka të bëjë me ngjarjen e 21 janarit, me sulmin ndaj Kryeministrit. Nëse lexohet shkrimi, është e qartë që bëhet fjalë për sulmin e dhunshëm ndaj Kryeministrit, i cili ka pasur si qëllim të shkelë mbi trupa e kufoma njerëzish për të marrë atë institucion. Kjo u konsiderua nga maxhoranca e atëhershme si grusht shteti. Ky është titulli që i referohet ngjarjes së 21 janarit, pra, tentativës për grusht shteti dhe nuk ka lidhje fare me atë që ka ndodhur me gazetarët. Unë nuk di që gazetarët e përmendur këtu të jenë dhunuar në restorantin ku kanë qenë, siç jam dhunuar unë në datën 26 maj.

Në lidhje më pamjet që paraqiten, është e vërtetë, unë nuk e mohoj që jam aty, por ju keni vetëm një sekuencë të atij momenti, pra vetëm sekuencën ku jam unë, por nuk keni sekuencën tjetër të vetëm 2-3 minutve më parë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një sekondë, ta mbaroj këtë pjesë!

Ju nuk keni sekuencat e vazhdimet të protestës dhe pjesën e mëparshme. Ju nuk keni goditjen dhe rënien pa ndjenja të 64-vjeçarit, Kastriot Hasko, i cili është përmendur vetëm në

spital. A e keni këtë pjesë kur bie pa ndjenja? Ma tregoni! Ajo ka qenë pjesa e agresionit, e cila na ka detyruar të gjithë ne që gjendeshim atje, në ato rrethanë, të vetëmbroheshim. Mos mendoni se do të gjunjëzoheshim, do të uleshim dhe do të shtriheshim si dele në rrugë, përkundrazi, do të qëndronim dhe do të evitonim çdo pasojë, që të mos kishim atë fat që pati ai 64-vjeçar, i cili përfundoi në spital pa ndjenja. Ky ishte qëllimi dhe këtë doja të sqaroja.

Ne lidhje me *bexhin*, në momentin e parë të gjithë gazetarët e kanë *bexhin* me vete për çdo rast, por a mund të kishe *bexh* me vete kur të sulmonin me shkopinj hekuri kokës? Mua me fluturuan syzet dhe çdo gjë që kisha me vetë. Ku ta gjeja *bexhin* që t'ia tregoja atij, që erdhi nga rreshti i dytë i Forcave Speciale, i cili qëlloi me shkop hekuri në kokë? A kisha kohë unë t'ia tregoja *bexhin* atij? Ka qenë ai që na detyroi të gjithë ne që ishim aty, të vetëmbroheshim, se nuk kishim zgjidhje tjetër. Ose do të shtriheshim si dele në rrugë dhe të prananim dhunën, ose të iknim më vrap, por nuk e bënim dot. Unë ju uroj të mos gjendeni asnjëherë në ato rrethana, sepse po të ishit, do të flisnit ndryshe! Ku ishte dhuna që ushtrova? Dhuna që kisha duart e mia? Cili polic u dhunua nga duart e mia? Cilin polic godita? Më thoni një polic të cilit ia rrëzova kapelën nga koka, më thoni një polic të cilin e godita me grusht apo me shpullë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ore, nuk është për Fatos Mahmutaj, ti fole për puçistët!

Musa Ulqini – Zonja kryetare, unë nuk i kam ndërhyrë askujt deri tani dhe shpresoj se kolegët e mi do të më respektojnë për aq minuta sa do të flas!

Do të flas shumë shkurt.

Nuk kam asnjë pyetje për të bërë, sepse nga data 26 e deri sot, në dijeninë time, gjërat janë të qarta. Zoti Kasmi është tashmë qartësisht e provuar që në protestë ishte një demonstrues i respektuar në të drejtën e tij, aktiv, por në momentet e fundit, një demonstrues agresiv. Në këto 25 vjet në këtë komision, në dijeninë time, gazetarët në detyrë dallohen nga vendi ku raportojnë, nga mënyra si raportojnë, nga shenjat dalluese dhe nga sjellja e tyre, gjëra që në rastin konkret zoti Kasmi nuk i kishte. Ju e keni thirrur këtë mbledhje në bazë të nenit 32, pika 2, të Rregullores dhe mendoj se do të kishit bërë mirë të ishit konsultuar edhe me ne, me sekretarin dhe me nënkryetaren, sepse, nëse do të kishte një konsultë, sot kjo mbledhje do të kishte kuptim.

Albana Vokshi – Po ju as Rregulloren nuk dini tani, Musa? Unë nuk kam si të konsultohem kur mbledh firmat e deputetëve. Merrni lexoni, se keni kaq vite deputet! Të lutem tani, se unë nuk konsultohem me ty, kur kam dëgjesa dhe marr firmat. Këtë mësojeni.

Musa Ulqini – Nëse do të ishte respektuar Rregullorja, ju e keni këtë të drejtë, nuk thashë se nuk e keni, por kjo seancë do të kishte kuptim, do të kishte normalitet dhe nuk do të kishit fare nevojë të mblidhnit firma. Ne nuk ishim kundër kësaj seance, por në këtë seancë ne duhet të ftonim njerëzit e dëmtuar në protestë, pra 4 protestuesit dhe 11 policët. Meqenëse komisioni ynë nuk është Komisioni i Ligjeve dhe i të Drejtave të Njeriut, duhej të ishin ftuar.

Albana Vokshi – Jam shumë dakord që të thërrasim policët në seancën tjetër, madje edhe shefin e policisë. Unë i kam vizituar vetë në spital. Kërkojeni! Por nuk e kërkon dot, sepse nuk ishin të lënduar.

Musa Ulqini – A ka mundësi ta mbaroj, zonja kryetare? Unë nuk i ndërhyra askujt. Shprehuni pasi të mbaroj unë! Respekto a-në e Rregullores!

Albana Vokshi – Po të sfidoj ta bësh kërkesën dhe hajde që të hënën! Ne thërrasim të gjithë policët dhe protestuesit.

Musa Ulqini – Me sfida në fund, siç e ka Rregullorja! Mos e shkel Rregulloren!

Albana Vokshi – Nuk mund të flasësh sa për të folur kot dhe për të hedhur hi syve. Nuk bën dot blofin.

Musa Ulqini – Sot unë do të flas siç e mendoj.

E treta, unë futem në grupin e deputetëve, që ka respekt të madh për protestuesit, sepse 18 vjet të jetës sime i kam kaluar duke organizuar protesta dhe i respektoj shumë protestuesit, kur kanë e kur nuk kanë të drejtë, por kurrë nuk kam lejuar, sa kohë kam drejtuar protesta këtu, në kryeqytet, që protestuesit të ushtrojnë dhunë. Gjithmonë jam distancuar nga dhuna e protestuesve, nuk jam avokat i dhunës.

Albana Vokshi – Po 21 janarin kush e bëri? Apo nuk ishte ti?

Musa Ulqini – Unë fola për 18 vjet që kam drejtuar protestën.

Albana Vokshi – Shumë mirë bërë që u distancove.

Musa Ulqini – A ka mundësi të flas? Kam të drejtën dhe kohën time.

Unë u bëj thirrje policisë dhe prokurorisë që të bëjnë punën e tyre sa më shpejt të jetë e mundur, të ndihmojnë opinionin publik që të mos ndodhin farsa të tilla.

Ka 3-4 javë që ju, në të drejtën tuaj, keni bërë pjesë të aksionit tuaj politik përpjekjen e çuditshme antikombëtare, siç e kam quajtur në shtyp apo në komision, për të bërë ç'është e mundur që të prodhoni çdo ditë, si sot, vetëm lajme negative, ku janë dhe ku nuk janë, vetëm me një arsye, ta pengoni Shqipërinë, me aq sa keni në dorë ju, për të mos hapur negociatat. Unë nuk e kam besuar që mund ta bënit një gjë të tillë, pasi forcat politike me kalimin e viteve nxjerrin mësim nga përvojat e tyre të gabuara dhe nuk e dija që një forcë politike, e

cila e dogji Shqipërinë me firmat piramidale si në 1997-ën, do të bënte ç'kishte të mundur për t'i djegur të ardhmen europiane Shqipërisë sot. Ju në komision, si sot, në seancë, si ditën e enjte, në aktivitetet që bëni, në protestën e 26 majit, në konferenca shtypi, në takime me të huajt, kudo ku jeni dhe ku nuk jeni, prodhoni vetëm lajme negative dhe të gjitha këto në emër të integritit.

Më kujtohet historia kur ju pushtuat RTSH-në për ta çliruar atë nga punonjësit e vet. Është e drejta juaj, por mund të them ...

Albana Vokshi – Po Griselda të kujtohet?

Musa Ulqini – Mund të them se kjo gjë regjistrohet nga të gjithë dhe efektet po japin rezultat.

Unë isha pardje në Belsh dhe thirrjes suaj për protestë iu përgjigjën 13 veta: kryetari i Partisë Demokratike, djali, vajza, dhëndri, 3 kushërinj të tij dhe disa të tjerë. U trishtova. Pse? Sepse të garantoj se 3500 votat e PD-së, sot që po flasim ne, duhet të ishin 4 mijë.

Albana Vokshi – Atë do ta shikojmë.

Musa Ulqini – Ka shumë gjëra për të protestuar, ka shumë gjëra që nuk shkojnë mirë pas 5 vjetësh që PS-ja ka edhe pushtetin qendror dhe vendor, por Belshi është monumenti më i mirë i qeverisë në këta 5 vjet, ndaj ishin aq pak njerëz atje. Megjithatë, ju u përpoqët të prodhoni një lajm negativ edhe atje ku nuk ka lajm.

E fundit, kjo ngjarje, me të cilën ju sot përpiqeni të prodhoni një lajm, ka ndodhur më 26 maj. Më kujtohet 26 maji i vitit 1996, kur ndaj deputetëve të opozitës në komisione u ushtrua një dhunë e pashembullt, që kulmoi në protestën e famshme të opozitës më 28 maj, ku partia që ti përfaqëson, zonja kryetare, nuk e di ku ke qenë atëherë, goditi përpara të gjithë ...

Albana Vokshi – Këtu kam qenë.

Musa Ulqini – Goditi përpara të gjitha agjencive, televizioneve, gazetarët ndërkombëtarë, gazetarët e huaj dhe liderët e opozitës.

Për ta mbyllur, nuk e mendoja dot që kjo njollë e zezë, që është në ballin tuaj ...

Albana Vokshi – Mirë bën që distancohesh nga 21 janari.

Musa Ulqini – ...kjo njollë e zezë, që është në ballin tuaj, nuk do të kishte lënë gjurmë. Nuk e kuptoj ku e keni ju të drejtën morale që prodhoni lajme të zeza atje ku nuk ka.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Musa Ulqini – Mendoj se kjo që po bëni në këtë komision, kjo që po bëni këto ditë, që thoni nga mëngjesi në darkë, deri në datën 28 ...

Albana Vokshi – 24 ditë ke, Musa.

Musa Ulqini – ... dhe bëni gjëra sa qesharake, aq edhe të turpshme.

Albana Vokshi – Ke 24 ditë.

Mos censuro, mos dhuno!

Musa Ulqini – ... në emër të integritimit, në emër të hapjes së negociatave...

Zonja kryetare, unë ndiej keqardhje shumë të madhe për ty, për ju dhe për të gjithë kolegët që ju detyrojnë, sepse nga ndërgjegjja juaj është e pamundur të bëni gjëra të tilla, që më e pakta, mund të them se janë akte antishqiptare, antikombëtare.

Albana Vokshi – Po Griselda çfarë ishte?

(Diskutime pa mikrofon.)

Edmond Spaho – Faleminderit!

Unë dua të shpreh indinjatën dhe dëshiroj ta hedh poshtë me përbuzje fjalorin që u përdor ndaj kolegëve të opozitës, duke i quajtur “vrasës”. Vrasësit gjejini në një drejtim tjetër, nuk janë tek opozita, as tani, as kur ka qenë në pushtet. Vrasësit i keni pasur midis jush, në parlamentin tuaj të viteve 2013-2017, madje u ndërpre çdo negociatë nga Komuniteti Europian për procesin e integritetit të vendit tonë, sepse kishim një parlament, një maxhorancë, një qeverisje të mbushur me vrasës, me kriminelë. Kjo nuk është retorikë politike, por fakt i vërtetë. Një takëm prej tyre e kanë lënë tashmë parlamentin, por nuk ka mbaruar, ka edhe të tjerë në parlamentin aktual. Këto fjalë merrini mbrapsht, nuk janë për ne, janë për ju.

Paralelja që po përpiqeni të bëni me 21 janarin është qesharake. I vratë një herë ata dhe po i vrisni për herë të dytë. Keni pasur 5 vjet kohë në dispozicion për të zbardhur të vërtetën, por e vërteta është një dhe është e thjeshtë: ishte puç kushtetues. Keni dashur të merrni pushtetin me forcë, me dhunë, duke e sulmuar Kryeministrinë me të gjitha mjetet e mundshme. Ky është dallimi ndërmjet nesh dhe jush. Ne nuk e marrim pushtetin me dhunë. Protestat tona, në dallim nga protestat tuaja, janë brenda limiteve demokratike, por, sigurisht, ka një moment që qytetarët reagojnë. Kur policia i provokon dhe i godet, siç goditi gazetarin në fjalë, njerëzit do të reagojnë. Por edhe në këtë rast Partia Demokratike u tregua forcë e përgjegjshme. Deputetët e saj, siç keni të gjitha regjistrimet, kanë dalë në krahë të policisë dhe kanë qetësuar njerëzit. Ky është dallimi i madh ndërmjet nesh dhe jush dhe më pas dallimi ndërmjet Edi Ramës dhe Lulzim Bashës. Ndërsa Edi Rama i nxiste me telefon nga kullat e tua, Fidel, Lulzim Basha erdhi, i tërhoqi njerëzit dhe i çoi te Partia Demokratike.

Unë e mbështes gazetarin Bledi Kasmi, sepse, duke mbështetur atë, dëshiroj të mbështes të gjithë gazetarët që janë këtu, që kryejnë punë në kushte shumë të vështira, që paguhen jashtëzakonisht keq dhe e ndjekin lajmin me 1 mijë e 1 vështirësi, sikur të jenë në terrene lufte. Pavarësisht se ai është gazetar i “ Rilindjes demokratike” dhe duket sikur ka konotacion politik, kushdo të ishte gazetar e të dhunohej kështu si Bledi, duke u goditur ashpër me shkop, ne do të reagonim. Për këtë ka prova të padiskutueshme, sado të bëjmë fjalë ne dhe të themi “e goditën me gurë protestuesit, ndaj iu ça koka”, pasi e patë *live* në të gjitha transmetimet e televizioneve, se si polici kërceu nga rreshti i dytë dhe e goditi me shkop. Çfarë shkopi ishte? Është shkop hekuri i veshur me gomë? Le ta zgjidhë prokuroria. E goditi dhe e çau ashpër në kokë, pati një hemorragji të pandërprerë dhe u desh ndërhyrja e mjekëve të specializuar edhe në vend, edhe në spitalin ku u dërgua. Është e turpshme që ne të dalim në mbrojtje të atyre që dhunojnë gazetarët.

Media është pushteti i katërt. Nëse sot ka degraduar në këtë gjendje, është, së pari, nga Kryeministri, i cili i quan “kazan”, kur kazani më i madh është ai vet, ka degraduar për shkak të presioneve që u bën ndërmjet pronarëve, fondeve publike që u jep dhe që i mban rresht. Këta më pas ushtrojnë forcë dhe presion ndaj gazetarëve në redaksitë e gazetave dhe të televizioneve për ta paraqitur të zezën të bardhë e të shtrembrën si të drejtë.

Do të ishte në dinjitetin tonë, sidomos në kushtet kur reagon një organizatë ndërkombëtare kaq e madhe, si “Reporterë pa kufi”, të reagonim në favor të gazetarëve. Kjo është puna juaj, këtë rrugë keni zgjedhur dhe nuk habitem. Unë e prisja që këtë qëndrim do të mbanit. Ju thashë që më duket qesharake paralelja që bëni me 21 janarin.

Dua të them dy fjalë edhe për gjendjen në tërësi pas aksionit të opozitës. Doja të kujtoja se sot janë mbushur 3 javë nga koha që ne kemi publikuar fakte për përfshirjen e vëllait të ministrit të Brendshëm në trafikun e drogës, jo vetëm në Itali, ku është dënuar me 7 vjet e 2 muaj, por edhe në Vlorë deri kohët e fundit. Nuk është marrë asnjë masë as nga policia, as nga prokuroria, as nga qeveria, që të mund të zbardhet e vërteta. Ka vetëm heshtje, vetëm tentativa për të prishur provat, vetëm presion ndaj opozitës, përbaltje, duke filluar nga kryetari i partisë deri tek anëtari më i thjeshtë i opozitës. Policia nuk mund të angazhohet të bëjë detyrën e vet, luftën ndaj krimit, për sa kohë që merret me të tilla gjëra, survejon, ndjek e mbikëqyr ku shkon kryetari i opozitës dhe drejtues të tjerë të saj. Për rrjedhojë, nuk habitem që sillen në këtë mënyrë me gazetarët dhe me qytetarët e vendit të vet, që i shtron në hu, si thotë një fjalë e urtë popullore.

Sot Fatmir Xhafaj po e arrin objektivin që kishte për të shantazhuar gazetarët. Tentoi të blinte me para edhe dëshmitarin kryesor, i ofroi 200 mijë euro, po i prish provat dhe vëllanë e dërgoi në mënyrë të paligjshme në Itali, por arkitekti i gjithë kësaj katrohure është vet Edi Rama. Fatmiri zbaton porositë e tij, sepse, po nuk u mbrojt Fatmiri, vëllai i Fatmir dhe Tahiri, i dalin të palarat e vet Edit, ndaj e liroi Tahirin, e dërgoi vëllanë e Fatmirit në Itali, ka kapur prokurorinë dhe gjyqësorin.

Sot nuk besoj se keni më dyshime që e mrekullueshmja reformë në drejtësi ka prodhuar vetëm dështim dhe kapje të sistemit. Këtë kemi pretenduar, e kemi thënë që kur filloi reforma dhe sot po vërtetohet. Një gjykatë që ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po ai çift gjyqtarësh që liroi Orest Sotën, që prishi provat, liroi edhe Saimir Tahirin. Të mos ketë njeri dyshime, pasi asnjë nga hetimet nuk do të prodhojë asgjë. Dyshimet ndërmjet këtij sistemi të kapur dhe sistemit të Italisë, i cili nxori edhe provat për Saimir Tahirin, është se atje po funksionon, u hetuan, po gjykohen dhe do të dënohen, kurse këtu njerëzit zhduken, lirohet Orest Sota, zhduken 3 drejtorët, lirohet Saimir Tahiri. Pra, shikojeni diferencën ndërmjet një sistemi të Bashkimit European, që funksionon dhe lufton krimin e organizuar, dhe sistemit tonë në Shqipëri, që gjoja e reformuam, që nuk kap asnjëri, por i lë kriminelët të livadhisin dhe të bredhin të lirë. Kjo është arsyeja pse do të dështojnë negociatat, pse nuk do të hapen negociatat, nuk është protesta në Belsh, Musa, as protesta në Elbasan. Ata nuk marrin vendime për fjalët dhe veprimet e opozitës, por marrin vendime për veprimet e maxhorancës, e cila ka vetëm një kusht: të luftojë krimin e organizuar dhe korrupsionin, që do të thotë se duhet të dënojë Saimir Tahirin, të hetojë dhe ta fusë në burg vëllanë e Fatmir Xhafajt e më pas të shikojë nëse ka lidhje ndërmjet dy vëllezërve. Nuk mund të jetë ministër i Brendshëm dikush që ka vëllanë të burgosur për krijim organizatash mafioze dhe për trafik ndërkombëtar droge. Përgjegjësinë për moshapjen e negociatave, për të cilën ne si opozitë themi: “larg qoftë”, sepse i kemi bërë shërbimin për vite e vite të tëra, por nëse ndodh, kërkojeni te vetja juaj. Ky është tërësisht dështimi juaj dhe vjen nga modeli i qeverisjes suaj.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Spaho!

Në fakt, zoti Ulqini, protesta na afron më shumë me Europën. Protestat paqësore janë gjithmonë një hap drejt Europës, sepse i kërkojnë dhe i kujtojnë qeverisë të plotësojë të gjitha kriteret. Ndaj, edhe protestat janë gjithmonë një hap drejt Europës. Mendoj se me atë që po

bëjmë, ne po e ndihmojmë rrugëtimin drejt Europës, të cilit ju po i nxirrni pengesa njëra pas tjetrës.

Po, zoti Shezai.

Shezai Rrokaj – Faleminderit!

Ndiej thellësisht keqardhje për këtë komunikim të pakëndshëm midis dy kolegëve të nderuar të këtij komisioni. Unë e dënoj këtë mënyrë komunikimi dhe shpresoj që të dy kolegët të kenë maturinë dhe pjekurinë e duhur për ta ngritur nivelin e diskutimit në ato nivele, që me të vërtetë i shërbejnë arsyes për të cilën ne jemi këtu. Unë nuk besoj se të gjithë ne nderohemi kur marrim në mbrojtje pjesët e errëta të historisë së mëparshme.

Roli ynë këtu nuk është roli i organit të prokurorisë, as të nxjerrim prova për të zëvendësuar rolet. Prokuroria rolin e saj duhet ta kishte luajtur atë ditë që ndodhi protesta, duke filluar kryesisht ndjekjen e procedurës penale për të zbardhur çështjen. Fakti që ne marrim role për të zbardhur të vërtetën, nuk na nderon, edhe në cilësinë e asaj që ne përfaqësojmë këtu. Ne duhet t'i themi prokurorisë që të hetojë për këtë rast, që për ne përbën problem kryesisht që është roli i gazetarit. Pra, ne këtu jemi për të mbrojtur gazetarin në cilësinë e gazetarit, jo thjesht gazetarin e një gazete të caktuar.

Problemi më i madh që ka demokracia në Shqipëri është se në momentin që cenohet gazetari, tregon se demokracia po deformohet. Për mua është shumë e rëndësishme që kjo të theksohet. Në momentin që ne e kthejmë gazetarin në skllav, e kthejmë gazetarin thjesht në përçues, i heqim atij logjikën dhe arsyen pse ai është bërë gazetar.

Ne vijmë nga ambientet akademike dhe në shkollë nuk u kemi mësuar gazetarëve që të bëjnë si u thotë pronari apo të ulin kokën përballë të vërtetës. Fakti është se deformimi i gazetarisë viktimizon, në radhë të parë, gazetarin dhe misioni i këtij komisioni është pikërisht ky, që ne të mos përmendim rastet se ku kemi gabuar si pushtete. Pushteti nuk përdoret për t'u hakmarrë, absolutisht pushteti nuk duhet përdorur për t'u hakmarrë. Këtu doli sikur po hakmerremi, meqenëse ju na e keni bërë kështu, edhe ne po jua bëjmë kështu.

Unë mendoj se ky nuk është modeli më i mirë për t'ia treguar Europës, për pjekurinë që duhet të kemi, në momentin e çeljes së negociatave. E kam thënë edhe atë ditë, por po e them përsëri: protesta është shenja më emancipuese e një demokracie. Imagjinoni një maxhorancë, që i ka të gjitha pushtetet dhe që vendos për gjithçka, e cila i ka votat në Kuvend dhe kontrollon në mënyrë të tërthortë drejtësinë dhe prokurorinë. Atëherë, si mund të mos ketë protesta, që të ngrenë problemet, të cilat po i ngrenë edhe ndërkombëtarët, që kanë lidhje me krimin, me drogën, probleme me ekuilibrin politik, probleme me administratën, probleme

me drejtësinë e njëanshme, probleme me respektimin e të drejtave të njeriut dhe me gjithçka tjetër? Pra, unë nuk mendoj se protestat janë të dëmshme, duket sikur janë të tilla, por protestat i bëjnë mirë demokracisë.

Unë jam shumë i shqetësuar për faktin se maxhoranca, në vend që të merret me qytetarët dhe me qeverisjen, merret me opozitën. Ne të opozitës këtë detyrë kemi, pra të merremi me maxhorancën, sepse ajo qeveris, kurse maxhoranca çfarë pune ka me opozitën?! Ne jemi një vend i çuditshëm, ku qytetarët më shumë gjykojnë se ku gabon opozita sesa gjykojnë qeverisjen. Shikoni modelet në të gjitha vendet që na rrethojnë, ku qytetarët merren me qeverisjen. Si mund të merren me opozitën?! Pra, këto janë modele të deformimit të demokracisë, që kanë të bëjnë me lirinë e gazetarëve. Ne vazhdojmë ende të transmetojmë me regji të kontrolluar. Pra, ka mbaruar demokracia, kanë mbaruar gazetaria. Çfarë bëjnë gazetarët në Shqipëri? Ata vendosin vetëm fisha, pra janë vetëm vënës të fishave. Nuk mendohet që gazetarët të shkruajnë atë që mendojnë, atë që i shërben demokracisë, atë që i bën ata të lirë. Prandaj, kjo dëgjesë sot i shërben një misioni më të madh: lirisë së gazetarit, sepse liria e gazetarit është liria për të vendosur demokracinë, pa të cilën ne nuk mund të përfshihemi dot në datën 28 qershor. Kjo nuk është një dëshirë e opozitës, unë nuk e quaj këtë dëshirë të opozitës.

Unë do t'ju lutesha shumë kolegëve të maxhorancës që të heqin dorë nga koncepti "tradhti kombëtare". Pse tradhti quhet të protestosh në demokraci?! Çfarë tradhtie është kjo?! Për çfarë proteston tjetër opozita, përveç atyre që vetë ndërkombëtarët i ngrenë si problematika?! Ku qëndron tradhtia këtu? A është tradhti antieuropaniste?!

Unë mendoj se nuk i takon këtij modeli të ri të parlamentit shqiptar, aq më tepër në prag të pritjes për hapjen e negociatave, ta interpretojë çështjen e protestës si një vënie shkopinjsh nën rrota për ecurinë e demokracisë. Përkundrazi, sa më shumë të protestohet, aq më shumë maxhoranca qartësohet dhe korrigjohet në rrugën e saj, dhe aq më shumë hapa të shëndoshë hedh Shqipëria për integrimin e saj në Europë, duke filluar, siç e thashë, nga çështja e gazetarit Bledi Kasmi, të cilin unë e kam pasur edhe student. Këtu nuk bëhet fjalë për çështjen e një emri të përveçëm, por është çështja e gazetarit.

U bëj thirrje medieve ta ngrenë kokën ata të parët, të bëhen viganë, jo pekmezë. Demokracia kërkon viganë nga të gjithë ne, duke filluar me gazetarët të parët, sigurisht pa i ngatërruar rolet, sepse ne nuk jemi këtu për të ndëshkuar kryerjen e detyrës nga ana e policisë, ata janë atje për të kryer detyrën e tyre brenda ligjit.

Kështu që ju bëj thirrje, të nderuar kolegë, që të bashkohemi në një deklaratë të përbashkët për misionin që ka vetë ky komision: mbrojtjen e gazetarit dhe mbrojtjen e fjalës së lirë!

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Unë dua të kujtoj edhe një herë se Partia Demokratike ka hartuar tashmë një draftrezolutë, duke u konsultuar edhe me palët e interesit, me shoqatat e medieeve, ku trajtohet çështja e dhunës së gazetarëve, shantazhi ndaj medieeve, censurimi i portaleve, të cilën shumë shpejt do ta dorëzojmë zyrtarisht edhe në Kuvend. Unë shpresoj shumë që ju, kolegë të maxhorancës, do të bashkoni votat dhe do ta miratojmë këtë projektrezolutë me vota unanime.

Po, zoti Nasufi.

Fadil Nasufi - Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë i bashkohem apelit që bëri profesor Rrokaj.

Komunikimi që ne po bëjmë, pavarësisht nga tensioni që u krijua, nuk duhet të dominohet as nga emocioni, as nga pasioni politik, as duhet ta marrim dhe ta kthejmë në një kauzë të opozitës, në mënyrë që më pas, nën hijen e kësaj, të dalim te problematikat dhe tek aksioni i përditshëm i opozitës.

Njerëzisht i uroj Bledit të shkuara dhe shërim të shpejtë, sepse, pavarësisht se ishte në rolin e një protagonistit aktiv në protestë apo në rolin e gazetarit, mision të cilin ai kryen, ne të gjithë jemi të ndjeshëm. Mbi të gjitha, ne vlerësojmë jetën e kujtdo, pavarësisht bindjes së tij, pavarësisht përditshmërisë së tij në jetë. Ne duhet të jemi më humanë një gjykimin tonë dhe në përfaqësimin e mandatit tonë, ndaj duhet të çlirohemi nga historitë e dhimbshme.

Ky protagonizëm shqiptar, me natyrë gjaknxehetë, na bën që ta shikojmë tjetrin si viktimë, duke anuar më shumë nga politika se sa nga ana humane, duke harruar rolin, misionin apo gjykimin e tij. E them këtë edhe për faktin se kur kujtoj Bledin, bëj apel edhe për shumë histori të dhimbshme të barbarizmit dhe dhunës shtetërore që kanë ndodhur në demokraci. Ju e dini shumë mirë se unë jam një nga protagonistët në politikën lokale që nga viti 1991, ndaj dua të kujtoj Edi Spahiun, i cili ka bërë 5 operime në kokë dhe kurohet prej 22 vjetësh si i gjymtuar dhe i traumatizuar nga një kryetar i FSHF-së, thjesht dhe vetëm se ka qenë në punën e tij dhe kishte zërin e lirë.

Kujtoj Luan Shmillin, i cili është arratisur në Itali, sepse përndiqej; kujtoj Bardhok Lalën, i cili u përgjak; Shyqyri Mekën, Ylli Polovinën, pse jo Aleksandër Frangaj, Martin

Lekën, misionarë të medieve dhe protagonistë kryesorë sot. Pse do t'i harrojmë ne këto histori të viteve 1994-1996?! A do t'i harrojmë në rastet ekstreme apo duhet të nxjerrim mësimë dhe të reflektojmë? A duhet të krijojmë fabula dhe metafora për binomet, që nuk kanë asnjë pikë takimi, binomi polici-protestues?! Nuk i takon kësaj kohe binomi polici-protestues, i takon kohës së famshme të Gazi Dedes.

Zoti Ulqini kujtoi Servet Pëllumbin, Namik Doklen, Blendi Gonxhen, Gaqo Apostolin, Skënder Gjinushin, si dhe gazetarët e huaj që u rrahën më 28 maj në sheshin "Skënderbej". Ne do të nxjerrim mësimë nga këto apo do të numërojmë rastet se si është sjellë ai pushtet në atë kohë? Unë po ju them se Berati bashkë me Libofshën kanë qenë projekte pilot të dhunës shtetërore në vitin 1994, në referendumin e famshëm të 26 majit, ku humbën jetën njerëz. Vullnet Kraku u rrah dhe pas dy ditësh vdiq, sepse në atë kohë nuk ishte kjo medie që është sot.

Prandaj, të nderuar kolegë, sot gjykojmë si në vitin 2018. Unë nuk jam këtu në rolin e një hetuesi, as në rolin e ndonjë organi të drejtësisë, por jam në rolin e deputetit. Shumë mirë që e kemi rastin sot në tavolinë që ta diskutojmë, por duhet ta gjykojmë me atë pikë vështrimi, që media të jetë e mbrojtur, të jetë e lirë, në mënyrë që të kryejë misionin e saj. Protestat duhet të jenë të garantuara, jo të dhunshme, si dhe duhet të respektohen institucionet e shtetit, të respektohet Policia e Shtetit, pa e provokuar dhe pa e cenuar në rolin e saj për mbrojtjen e institucioneve shtetërore.

Prandaj, e mora fjalën në këtë dëgjese publike, jo për të bërë historikun, se kemi edhe viktimat e dhunës në medie, por për të reflektuar të gjithë së bashku. Aktorët politikë duhet t'i drejtojnë protestat me mesazhe paqësore, mediet duhet të bëjnë rolin e tyre, në mënyrë që kur të shkojnë në protestë të jenë me të gjitha identifikimet e mundshme, ku gazetarët apo kameramanët të bëjnë punën e tyre dhe të mos bëjnë rolin e dhunuesit apo të protagonistit aktiv, detyrë të cilën më pas do ta gjykojnë institucionet e drejtësisë, të cilat gjykojnë akte të tilla.

Kam një apel për kolegët e opozitës: askush nuk jua heq të drejtën e protestës në përditshmëri, askush nuk jua heq të drejtën që të ngrini zërin, ashtu siç i gjykoni ju veprimet e qeverisjes, por duhet ta bëni me një lloj përkushtimi, si shqiptarë, në kuadrin e hapjes së negociatave dhe vullnet të shëndetshëm dhe të përbashkët! Këtë detyrim që kemi të gjithë para shqiptarëve, duhet ta shfaqni dhe jo sa herë që të merrni mikrofonin duhet të nxini gjithçka, të njollosni gjithçka, por duhet të filloni të jepni më tepër argumente për realitetin dhe qeverisjen që ne kemi sot.

Albana Vokshi – Faleminderit, zoti Fadil!

Ju falënderoj, sepse ishit i vetmi që u distancuat nga dhuna dhe bëtë thirrje për t'u bashkuar kundër dhunës në media.

Fjalën e ka kërkuar zoti Gurakuqi.

(Diskutime pa mikrofon.)

Nuk jeni shprehur qartë, prandaj duhet ta thoni edhe një herë. Ja ku është deklarata, ju ftova...

Fjalën e ka Romeo.

Më pas kemi edhe shumë diskutime të tjera.

Pra, fjalën e kanë Romeo, Vilma, Milva, por do t'i ndaj.

(Diskutime pa mikrofon.)

Deputetët e krahut që unë përfaqësoj po e marrin fjalën për pyetje dhe për konstatime.

Ju lutem, përmblihdhini diskutimet, se kemi shumë!

Romeo Gurakuqi – Faleminderit!

Në radhë të parë dëshiroj të falënderoj gazetarin Bledi Kasmi, për shpjegimin e qartë, si dhe qetësinë me të cilën argumentoi pozicionin e tij në një ngjarje të padëshiruar për demokracinë shqiptare në vitin 2018.

Së dyti, më duhet të nënvizoj për publikun faktin që, në qoftë se negociatat nuk do të hapen në fund të muajit qershor, kjo vjen para së gjithash për shkak të rënies së standardit të lirisë në përgjithësi, për shkak të rënies së nivelit të lirisë së medias në Shqipëri, për shkak të kaosit dhe vakumeve institucionale të krijuara nga reforma të pamenduara dhe të paqarta të marra nga qeveria aktuale, mbi të gjitha për shkak të nënvendosjes së Policisë së Shtetit në funksion të politikës së ditës dhe të ministrit të Punëve të Brendshme i kapur në trafik, si institucion.

Së treti, është e papranueshme për standardet e këtij komisioni shantazhimi i deputetëve të opozitës dhe mbi të gjitha ngritja e dorës nga pozitat e superioritetit në kastën drejtuese qeverisëse të këtij vendi, i cili ndodhet nën një qeverisje jonacionale, por nën një qeverisje, e cila është e fokusuar kryesisht në interesat regjionale të deputetëve ku ka marrë votat kjo qeveri.

Gjithashtu, më duhet të tërheq vëmendjen, për një përshkallëzim prej 4 muajsh nga ana e Policisë së Shtetit dhe e Ministrisë së Punëve të Brendshme të situatës, të sjelljes së qeverisë ndaj publikut dhe mbi të gjitha për shkeljen flagrante të nenit 11, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut në të cilën Shqipëria aderon. Pikërisht, ky nen garanton të

drejtat e lirisë së grumbullimeve dhe të drejtën e protestës. Prej 4 muajsh në mënyrë sistematike, unë personalisht, por edhe të gjithë kolegët dhe opinionin publik po ndeshemi me një sjellje të posaçme të Policisë së Shtetit për një aktivitet protestues të ligjshëm, për të cilin është marrë leje. Pra, praktikisht në mënyrë sistematike ish-oficerë të Ministrisë së Punëve të Brendshme të diktaturës, të risjellë në funksion të Policisë aktuale të Shtetit dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme hyjnë brenda protestuesve, filmojnë me metoda të paligjshme të policisë së fshehtë të fundit të viteve 1990 dhe fillimit të vitit 1991, vendet e manifestimit për të cilat është marrë leje. Është rrethuar në datën 26 maj padrejtësisht një hapësirë, për të cilën është marrë leje, me një kordon hekurash, e cila duhej të ishte e lirë dhe e paprovokuar nga ndërhyrja e Policisë së Shtetit. Komunitete të lira kanë marrë leje për të zhvilluar protestë, ndërsa policia aplikon metoda, të cilat u përkasin vendeve që janë të ngjashme me diktaturat.

Në fund fare, dua t'ju kujtoj, sidomos deputetit Ulqini dhe posaçërisht deputetit Fidel Ylli, që në muajin mars të këtij viti 23 qytetarë të lirë të këtij vendi janë arrestuar, në kundërshtim me kartën e lirive dhe Kodin e Procedurës Penale, natën, në Shqipërinë Verilindore, respektivisht në Kukës, për shkak të pjesëmarrjes në një protestë të paralajmëruar dhe për të cilën është marrë leje.

Pra, prej 4 muajsh kemi të bëjmë me shkelje sistematike të të drejtës së protestës, respektivisht të nenit 11 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Do të mjaftonte vetëm provokimi i dhunës nga ana e Policisë së Shtetit në tunelin e Kalimashit, rrethimi i bulevardit në datën 26 maj nga Policia e Shtetit në një hapësirë ku ishte marrë leje dhe gjakosja e gazetarit Bledi Kasmi që dikush do të duhej të dorëhiqej, pa llogaritur të gjitha faktet, të cilat opozita dhe shoqëria civile i kanë nxjerrë kohët e fundit për sjelljen e papërshtatshme dhe të nënvendosur të Policisë së Shtetit ndaj ministrit të Punëve të Brendshme për interesa private.

Vjen momenti për të zgjidhur konfliktin midis pretendimit tonë për shkelje të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe pretendimit tuaj se ju respektoni kartën e lirive. Cili është institucioni që do ta zgjidhë? Është gjykata. Ku është gjykata shqiptare në këto momente? Për shkak të asaj, të cilën e kemi trajtuar edhe radhën tjetër, kjo gjykatë është jofunksionale dhe nuk mund ta zgjidhë konfliktin, pretendimet tona dhe tuajat. Në çdo vend tjetër kur institucioni, reformatoret e direktoratit të Komisionit të Ligjeve, kanë krijuar një precedent të lënies së vendit pa një sistem gjyqësor, duhet të marrin përgjegjësi për atentat ndaj Kushtetutës, por këtu askush nuk mban përgjegjësi dhe ne si ligjvënës nuk marrim asnjë masë për ta eliminuar këtë boshllëk nga pikëpamja kushtetuese.

E ndiej për detyrë t'ju paralajmëroj, të nderuar kolegë të maxhorancë, si dhe publikun në përgjithësi, se qeveria shqiptare me metodën e saj të arrogancës dhe të mosdëgjësës ekstreme javën në vijim ka vendosur të aplikojë sërish pa një ligj të parlamentit, e theksoj, taksën e re për Rrugën e Kombit. Do të jeni përsëri para të njëjtave turbulenca, të cilat i keni kaluar para 3 muajsh dhe përpara një represioni të ri të mundshëm hipotetik nga ana e ministrit të Brendshëm, i cili kontrollon në mënyrë të pandërgjegjshme Policinë e Shtetit.

Unë kërkoj që kjo orvatje të ndalet. Duhet të keni parasysh që nuk ka taksa me VKM, nuk ka taksa pa përfaqësi.

Pyetja tjetër që ju bëj është kjo: me çfarë të drejte Kryeministri i vendit e reformat me mënyrën e tij taksën për Rrugën e Kombit, duke kompensuar nga buxheti i shtetit pjesën që kërkon ta kompensojë dhe që është e paarsyetuar?

Duhet të keni parasysh se Rruga e Kombit lidh Shqipërinë me Kosovën, është e vetmja rrugë lidhëse midis dy vendeve. Kjo rrugë nuk i përket vetëm popullit të Kukësit, por i përket gjithë Shqipërisë së Veriut dhe Shqipërisë së Jugut, është një nyje ndërlidhëse shumë e rëndësishme, prandaj duhet ta ndalni sjelljen; ju takon ju dhe kjo është pjesa juaj më së shumti, për të treguar autonominë si legjislatorë, të ndalni përpjekjet e mëtejshme të kryetarit të qeverisë për të operuar mbi bazën e sjelljeve dhe të raporteve personale që ai ka me firmat private në pakte të paqarta dhe aspak transparente.

Ju faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Po lexoj radhën e personave që e kanë kërkuar fjalën: Vilma, Kejdi, Adelina kanë një pyetje, Milva dhe Genti.

Ju lutem, përmbledheni fjalën tuaj dhe ato që nuk kemi trajtuar ende.

Vilma Bello – E përshëndes gazetarin Kasmi dhe i uroj shërim të shpejtë. Disa kolegë të opozitës e kërkuan këtë mbledhje komisioni, këtë dëgjese dhe, siç e shihni, nga maxhoranca nuk mungon asnjë nga deputetët, në respekt të plotë të medias, të fjalës së lirë dhe të së vërtetës. Pra, meqë jemi mbledhur në këtë dëgjese me gazetarin, si dhe në respekt të plotë të punës dhe të tij personalisht, do ta nisja fjalën me një pyetje për gazetarin, përgjigjen e së cilës mund të ma jepni në fund të fjalës.

Ju thatë se keni 24 vjet punë si gazetar, do të doja të dija prej jush dhe të kuptoja se si e ushtroni ju detyrën e gazetarit, sa kohë që në filmimet që ne disponojmë ju nuk dilni në detyrën e gazetarit, por duke ushtruar detyrën e një protestuesi aktiv? Si ka mundësi që vetëm gazetari Kasmi dhe disa prej jush, kolegë të opozitës, disa ishin më afër dhe disa më

larg nga gazetari, të pranohet se keni paraqitur plotësisht të vërtetën e ngjarjes së asaj dite, kurse mediet e tjera nuk e kanë paraqitur këtë të vërtetë, po i referohem këtu asaj që tha kolegu Baçi? A mos vallë janë duke u cenuar mediet e tjera nga ky konstatim?

Në këtë vend sigurisht është protestuar vazhdimisht, unë i vlerësoj protestuesit për të drejtat e tyre, për fjalën e tyre, për çfarëdolloj gjëje që ata ndërmarrin për të qenë pjesë e protestave që në këtë vend dhe në këtë demokraci kanë qenë të vazhdueshme, por nuk besoj të gjendet ndonjë të mos kujtojë se çfarë ka ndodhur këtu përballë nesh më 21 janar, ku shteti ka dhunuar qytetarë dhe gazetarë. Jam dakord me ato që tha kolegu Rrokaj, të mos u qëndrojmë gabimeve të së shkuarës, por do të ishte mirë të përdornim të njëjtën masë gjykimi për ngjarje që lidhen me gazetarët apo me dhunën ndaj tyre.

Zonja kryetare e komisionit, këtu jemi në Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe pikërisht për këtë dhe më së shumti për këtë, jeni ju e para në cilësinë e kryetares së këtij komisioni të nderuar, që duhet të mos çedukoni, duke keqinformuar qytetarët dhe duke e përdorur medien për ta bërë këtë gjë. Është e disata herë që ndodh kjo gjë. Askush nga kolegët dhe deputetët e maxhorancës së këtij komisioni nuk ka thënë se gazetari ka përplasur kokën pas hekurave dhe është vrarë...

Albana Vokshi – Lexoni procesverbalin...

Vilma Bello - ... në qëndrimin tim personal, sigurisht dënoj çdo lloj forme dhune, ashtu siç kam dënuar dhunën e shtetit në çfarëdolloj forme që e ka dhënë dhe në çdo kohë që e ka dhënë, dhe i uroj sërish të shkuara gazetarit, por nuk arrij ta kuptoj se në fillim debati dhe dëgjesa nisi në respekt të gazetarit dhe të gjithë kolegëve të opozitës, dhe me t'u rikthyer maxhoranca, e cila duhej ta merrte fjalën për të pasur një barazi në fjalë, u ngritët. Nuk flisni dot për arrogancë, zonja kryetare e komisionit, sa kohë që jeni ju e para duke na dëshmuar se mbani një qëndrim të tillë.

Së fundi, do t'ju kërkoja diçka si deputete e një qarku shumë të nderuar, atij të Vlorës, si deputete e këtij komisioni dhe e parlamentit, në emër të së drejtës së qytetarëve dhe të të gjithë shqiptarëve, që të mos bëni ç'është e mundur dhe të gjeni lloj-lloj shkaqesh, për të errësuar gjithçka që ndodh në këtë vend dhe që bëhet më e mira për këtë vend, sepse duhet ta duam njësoj këtë vend, por me sa duket nuk qenka kështu.

Ju lutem, jua kërkoj këtë që të jemi bashkë dhe të kontribuojmë sadopak dhe sa të mundemi për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin European.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Ti Vilma, a e do Vlorën?

Vilma Bello – Shumë.

Albana Vokshi – Vlorën e ktheu në hambar droge, të gjitha bandat, të gjithë ministrat, të gjithë ish-ministrat ishin të lidhur me trafikantë nga Vlora. Si nuk e keni ngritur një herë zërin për këto?!... Ish-ministri i Brendshëm me Habilajt...

Vilma Bello – E kam ngritur zërin plotësisht dhe mos përsëritni ligjëratat tona...

Albana Vokshi – Ministri i tanishëm me vëllain...

Po si nuk fole një herë për vlonjatët?

Vilma Bello – Kam folur shumë për vlonjatët e denjë që punojnë denjësisht dhe jetojnë denjësisht..

Albana Vokshi – Distancohu, se për këtë po protestonim...

Vilma Bello – Vlonjatët përfaqësohen denjësisht në këtë parlament...

Albana Vokshi – Me kë?

Vilma Bello - Përfaqësohen denjësisht nga deputetët e maxhorancës...

Albana Vokshi – Me Habilajt, me vëllain e ministrit, me këta përfaqësoheni ju!?

Vilma Bello - ... për të gjithë ata qytetarë që punojnë dhe janë të mrekullueshëm. Mos cenoni qytetarët, sepse...

Albana Vokshi – Vilma, të lutem, të paktën ti, si grua, si nënë, distancohu nga droga, distancohu nga ministri, thuaj ta shkarkojnë, sepse nuk i bën nder Vlorës që përfaqësohet me...

Vilma Bello – Unë distancohem nga komunikimi juaj në këtë komision.

Albana Vokshi - Po, zoti Kasmi.

Bledi Kasmi – Falënderoj deputeten për pyetjen, por edhe për mesazhin e dënimit të dhunës, ashtu sikurse bënë edhe deputetët e tjerë të opozitës, si dhe disa nga deputetët e maxhorancës. Mendoj se gjëja kryesore duhet të ishte dënimi i dhunës, sepse vetëm në këtë mënyrë ne mund të shpëtojmë vendin nga futja në një cikël dhune, prej të cilit nuk do të ketë asnjë përfitues.

Në lidhje me pyetjen që bëri zonja deputete, dua t'i jap dy përgjigje:

Së pari, për pozicionin tim, atë ditë ka ndryshuar disa herë, sepse e tillë ishte dhe protesta. Sot raportimet për shkak të teknologjisë bëhen edhe nëpërmjet telefonit, aty mund të bësh edhe fotot, edhe publikimin, mund të bësh dhe raportimin. Kjo është gjitha.

Së dyti, pse u godita vetëm unë, kjo është e njëjta pyetje që ngre dhe unë: pse u godita vetëm unë?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju thatë: “ Aty kishte gazetarë të tjerë dhe pse u godit vetëm ai”?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Faleminderit!

Albana Vokshi – Urdhëroni, zonja Mehmetaj!

Kejdi Mehmetaj – Faleminderit!

Të them të drejtën kisha menduar që seanca e sotme dëgjimore do të kishte një tjetër drejtim. Mendoj se dëshmia e gazetarit, por në vend të gazetarit mund të ishte një protestues apo qytetar tjetër shqiptar, dhe do të kishte po të njëjtën rëndësi, të paktën për mua, do të ishte e mjaftueshme për të na sensibilizuar ne, si deputetë, jo të këtij komisioni, por me përgjegjësinë që na kanë dhënë qytetarët, për të marrë të gjithë hapat dhe gjitha reagimet, që t’ju bëjmë të qartë të gjithë qytetarëve se në këtë vend mund të protestosh i lirë kur je qytetar, kur je gazetar, kur je profesionist, pavarësisht se çfarë pozicioni mban në jetën tënde. Mund të protestosh i lirë dhe pa qenë i frikësuar se ajo protestë do të çojë në spital, do të çojë në burg dhe akoma më keq, mund edhe të të marrë dhe jetën. Por me sa duket jemi shumë të ngarkuar emocionalisht, edhe kolegët e maxhorancës, ndoshta shpesh situatat na dalin jashtë kontrollit. Sinqerisht, ndiej keqardhje, sidomos nga diskutimet e kolegëve, që kanë shumë vite eksperiencë në politikë, se mund të priten emocione, mund të priten diskutime nga kolegët të rinj, nga njerëz që e kanë të pamundur që të kontrollojnë emocionet, por nga kolegë që kanë vite që merren me këtë punë, nuk prisja deklarata të natyrës: “Ne justifikojmë veprimet që bëhen tani, sepse ky gazetar dikur qenka shprehur kundër maxhorancës së sotme”, siç ishin rastet që u treguan këtu. Nuk e kuptoj se si mund të thuhet nga kolegët me eksperiencë në këtë komision: “Nuk ka problem, derisa ka ndodhur më parë, mund të ndodhë edhe tani, ne nuk bëjmë aq keq sa më parë, por nuk ka problem, edhe po u bë më keq, kjo situatë kështu vazhdon”.

Po sikur ne të themi këtu, meqenëse Partia Socialiste ka një të shkuar historike: “Shiko, më parë ka pasur një diktaturë, ka qenë parajsa e partisë suaj, tani le ta kthejmë përsëri, nuk prish punë, sepse kështu ka ndodhur edhe më parë.”. A ka kjo ndonjë sens logjik? Për mua nuk ka fare sens. Ndaj, kisha shprehur shumë që në pjekurinë tuaj të gjithë këtyre viteve në politikë, sot të kishit përgjegjshmërinë dhe të dënonit dhunën, nga kushdo që ka ardhur ajo, dhe, mbi të gjitha, të kërkonit që siç procedohen qytetarët e lirë, ashtu të procedohet edhe Policia e Shtetit për të gjitha rastet e dhunës që është ushtruar ndaj protestuesve.

Zoti Ulqini, ju thatë se keni respekt për protestuesit. Unë e di se ju keni qenë një nga ata që keni organizuar protesta rinore në shumë vite, si ndieheni ju kur vajza të reja, studente të shkëlqyera, dalin protestojnë dhe arrestohen dhe dhunohen nga policia? Si ndiheni ju kur djem të rinj, qytetarë të jashtëzakonshëm të këtij vendi, ata pak që kanë që kanë ngelur këtu, shkojnë protestojnë dhe dhunohen nga policia, burgosen me ditë të tëra? Si ndiheni ju kur qindra qytetarëve shqiptarë sot u janë hapur procedime penale, sepse kanë dalë dhe kalë protestuar të lirë, pa bërë asnjë gram dhune? Ndërkohë, unë nuk di të ketë asnjë rast të vetëm, që të jenë marrë masa apo të ketë një procedim penal, apo të ketë një hetim për mënyrën se si Policia e Shtetit sillet me protestuesit dhe, mbi të gjitha, se si zyrtarët e lartë të kësaj qeverie sillen me protestuesit. Ka pasur policë që kanë dhunuar deputetë, duke thënë se nuk e njihnin deputetin, ndërkohë që tentonte të hynte në parlament, dhe ende sot e kësaj dite nuk ka asnjë procedim, asnjë masë të marrë, ndërkohë të gjithë ne, që jemi këtu, kemi qenë në rajone policie, kemi qenë nëpër komisarate, jemi të proceduar e kështu me radhë. Sinqerisht, nuk arrij ta kuptoj se si ju nuk përpiqeni, për hir edhe të qeverisjes suaj, që këto situata të normalizohen. Nuk e di, por mua nuk më duket i arsyeshëm ky lloj reagimi nga ana juaj sot.

Nga ana tjetër, përmendim këtu histori, që për mua janë qesharake, janë bërë dhe patetike të atdhedashurisë, por kush e do vendin më shumë dhe kush e do më pak, këtë nuk di ta them. Meqenëse ju e dini, më thoni çfarë vlerëson më shumë BE-ja, protestën apo kuintalët dhe kilet e drogës, që janë gjithandej nëpër Europë, që vijnë, kryhen dhe transportohen nga Shqipëria dhe që mbështeten nga kjo qeveri, e vërtetuar, nga një ministër dhe një ish-ministër i Brendshëm që janë të përfshirë drejtpërdrejtë në këto çështje?! Çfarë vlerëson më shumë Bashkimi European: qytetarë, të cilëve u respektohet e drejta për të protestuar, qoftë kjo edhe për kauza që mbase ju nuk i konsideroni të arsyeshme, apo qindra mijëra azilantët, që dergjen sot nëpër azilet e Francës, nëpër azilet e Gjermanisë, nëpër azilet e Holandës, nëpër azilet e vendeve Nordike? Besoj se ju, si deputetë të vjetër, jam e sigurt për këtë, keni pasur shansin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...që, po ashtu si një pjesë e jona, të takoni shumë përfaqësues ndërkombëtarë, qoftë të vendeve tona aleate, qoftë të Bashkimit European, qoftë të Parlamentit European dhe kështu me radhë. Asnjë prej tyre në asnjë takim të vetëm, nuk kanë thënë se është keq të protestosh dhe që është gabim të protestosh. Përkundrazi, në çdo takim është folur për të drejtat e njeriut, për liritë njeriut, për trafikun dhe për azilkërkuesit. Pse nuk flisni dhe nuk mbani përgjegjësi për këto gjëra, por vini këtu dhe, pa asnjë lloj logjike, dhe jam e shokuar nga kjo seancë e sotme, sepse sinqerisht nuk kisha menduar se do të ishte e nevojshme të zgjaste kaq

shumë, dhe na tregoni ne atdhedashurinë? Kjo është pa asnjë lloj kuptimi dhe pa asnjë lloj sensi. Si deputetë, merrni përgjegjësitë tuaja, sepse jeni ju të zgjedhurit kryesorë, jo ata qeveritarët atje, jo ata ministrat atje, edhe ju njësoj si ne t'u kërkon llogari, sepse bëhet fjalë edhe për njerëzit tuaj këtu, dhe për familjet tuaj, që po e shikojnë të pamundur të jetojnë në Shqipëri dhe çdo ditë po ikin. Ndaj, bëjeni me më shumë përgjegjshmëri detyrën tuaj, minimumin, në qoftë se nuk keni mundësinë ta bëni, të paktën evitoni konfliktin e panevojshëm dhe komplet personal me deputetët e opozitës në këtë komision.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Urdhëroni, zoti Ulqini!

Më pas fjalën e ka zonja Ekonomi.

Musa Ulqini – Para folësja ma përmendi emrin. Unë kam shumë gjëra që nuk i kuptoj ende dhe mësoj çdo ditë, edhe pse jam deputeti më i vjetër. E vetmja gjë që nuk po arrij ta kuptoj, dhe ky duhet të jetë defekti im, është se si ka mundësi një forcë politike që ka qenë 8 vjet në pushtet, na tregon me gisht ne dhe thotë se gjithçka që është e zezë në këtë vend, është për shkak të PS-së; nxjerr të rinjtë dhe i keqpërdor në protesta dhe demonstrata, sikur gjithçka këtu u përkeqësua në 8 muaj. Kjo është e vetmja gjë që nuk e kuptoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Çfarë është ky fjalor që keqpërdoret, të dalin dhe të protestojnë të rinjtë në vend, që të ikin, sepse ke 1 milionë shqiptarë që po ikin, 80%.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kejdi Mehmetaj – Më vjen shumë keq, sepse ke punuar edhe me të rinjtë, Musa. Në qoftë se ti mendon se përdoren të rinjtë, atëherë ju qenkeni përdorur për gjithë këto vite, sepse keni qenë po aq të rinj sa ne, kur jeni futur në politikë. Më vjen shumë keq që na flisni sot për qeverisjen tonë 8-vjeçare, kur kemi qenë ne në 4 vjet që u kemi thënë, në mënyrë të përditshme, se sa keq po i bëni këtij vendi. Prandaj nuk jemi më bashkë dhe prandaj jeni të vetëm sot që përballeni me gjithë këto akuza të rënda. Ndaj, nuk e kuptoj ku e gjeni guximin dhe drejtoheni me këtë lloj forme!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Të lutem, Musa, mos e merr më fjalën! Nuk do të replikoni vetëm ju të dy. Replikove, do të replikojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kejdi Mehmetaj -E kuptuam qëndrimin tuaj atdhetar, kundër protestuesve, kundër shprehjes. Nuk ka nevojë, sepse na kuptojnë qytetarët.

Musa Ulqini – Jam shumë i lumtur se qytetarët shqiptarë e kuptuan këtë gjë, që unë nuk e kuptova dhe vota flet vetë.

Albana Vokshi – Urdhëroni, zonja Ekonomi!

Më pas fjalën e ka Genti.

Milva Ekonomi – Faleminderit, zonja Vokshi!

Në fakt, besoj se për të gjithë anëtarët e komisionit ishte e rëndësishme që të ishim në këtë dëgjese dhe të dëgjonim si e mendonte gazetari Kasmi rastin e tij. Duke dëgjuar gazetarin Kasmi, së pari, dua t'i them atij të shkuara dhe shërim sa më të shpejtë! Besoj se situata shëndetësore juaja është më mirë, kështu që ju uroj shërim të shpejtë!

Megjithatë, kam disa çështje, që ngre pikëpyetje te vetja ime:

Së pari, atë ditë që ndiqja protestën, kur kam parë filmimet e ndryshme, vura re se ju ishit një gazetar, që nuk ishit pajisur me bexhin, nuk kishit asnjë bexh të shquar diku tjetër, që të tregonte origjinën e shërbimit tuaj, ndërkohë ishit një qytetar i zakonshëm për nga pamja, që merrnit pjesë në një protestë, pra ishit një protestues. Ndërkohë, në qoftë se duhet t'i referohemi manualit të gazetarit, në manualin e gazetarit është e shkruar shumë qartë: një gazetar, pavarësisht se i kujt medie është, duhet të ketë shenja dalluese në trup, që tregon se është duke bërë detyrën, është mirë të jetë i distancuar nga turma, sepse bën turmën të jetë më pak e motivuar ose më shumë e motivuar, domethënë ia heq mundësinë motivimit real, ndërkohë që turma është motivuar për arsyen e saj. Gazetarit i caktohet një vend ku mund të flasë, të shkruajë dhe mund të raportojë, në median e tij në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ndërkohë, nga pamjet e asaj dite, kemi edhe një foto të këtij lloji, që tregon se policia ka marrë masa mbrojtëse për gazetarët që ishin të pajisur me bexh dhe po bënë detyrën.

Albana Vokshi – Milva, shikoje pak këtë. Të paktën hiqini logon e asaj ku e keni marrë, sepse e ke me rreth. Hiqni logon e televizionit dhe merrni një asnjanes.

Milva Ekonomi – Edhe ne nga burim asnjanesë e kemi marrë.

Albana Vokshi – Pse nuk i referoheni kësaj ju?! Shikojeni, e keni te rreshti i dytë që vjen, fol edhe për atë.

Milva Ekonomi – Do flas dhe për atë. Ai duke qenë një gazetar, natyrisht e kupton shumë mirë se kur ka një protestë, në manual ka dhe një shpjegim se si reagon policia. Policia reagon nëpërmjet Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë me dy rreshta, rreshti i parë ka mburojë dhe rreshti i dytë ka shkopinj të gomës për të parë kur tejkalohet masa, që policia do të marrë në mbrojtje institucionin apo një grup të caktuar individësh. Në këtë rast policia ishte e pajisur me një shkop gome, të cilin e përdori ndaj jush.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Pse, çfarë po bënte Bledi në atë kohë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Meqenëse po na i sqaron, çfarë po bënte Bledi në kohën kur u qëllua?

Milva Ekonomi – Nuk ka qenë shkop hekuri. Ju më latë kohë të shikoja videon, por nuk kam nevojë të bëj replikë me ju.

Albana Vokshi – Jo, mos nxirrni vetëm ato të manipuluarat...

Milva Ekonomi - Nuk kam nevojë të bëj replikë me ju. Më lër të flas për atë që po shikoj.

Albana Vokshi – Jam dëshmitare, kam qenë aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ore, pse flisni me publikun, tregoni të vërtetën?!

Milva Ekonomi - A mund të vazhdoj?

Albana Vokshi – Mirë po e sqaron: gardhi i parë, gardhi i dytë; nëse ka momente dhune, po ushtronte dhunë?!

Milva Ekonomi - Këto janë rregulla fikse, ndërkohë zoti Kasmi, i papajisur me këto gjëra, duke qenë në rreshtin e parë të protestuesve aktivë, sepse e pamë që ju shtynit diçka prej hekuri, një ndarëse, pësuat një goditje. Mendoj se goditja juaj nuk ka qenë goditja ndaj një gazetari, por ka qenë goditja ndaj një protestuesi. Kur ne bëhemi gati për të bërë një protestë, pa dyshim që bëhemi gati të mendojmë për kokën tonë...

Albana Vokshi – Milva, ja ku e ke, të targetuar, nga rreshti i dytë vjen.

Nuk mund të thuash se nuk ishte. Shikoje, është e targetuar.

Milva Ekonomi – Po, nga rreshti i dytë.

Të lutem, më lër të mbaroj! Unë nuk ju ndërhyra kur folët.

Albana Vokshi – Po sqaroje ashtu siç është!

Milva Ekonomi - Unë do të sqaroj ata që na dëgjojnë, ata le ta gjykojnë se kush e ka më saktë dhe më mirë. Mendoj se kur individ proteston, dhuna ndaj policisë është një argument që individët, të cilët janë në protestë, e kanë marrë parasysh se mund të eskalohej, por, nga ana tjetër, mund të ushtrohet edhe dhunë ndaj tyre. Natyrisht, është e dëmshme për çdo individë mbi të cilin ushtrohet dhunë, qoftë ata demonstrues, që ishin 4, dhe ju ishit një nga ata të 4-t, qoftë dhe për 11 policët, që pësuat dëmtime nga kjo protestë.

Ndërkohë, ju folët për Kastriot Haskon, për të cilin ndërkohë që ju folët, unë u interesova dhe ai ka qenë në spital me lipotemi, ka marrë shërbimin e caktuar, në orën 12:40, kur është paraqitur, dhe më pas është larguar nga spitali në orën 16:40.

Albana Vokshi – Milva, mos u bëni qesharakë, ai është me protestuesit e tjerë në spital.

Milva Ekonomi – Të lutem, mos më ndërprit!

Albana Vokshi – Çfarë po thoni, mos mashtroni kështu?! Ai ka shkuar direkt nga protesta aty. Mjaft, mos mashtroni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Më lini të mbaroj.

Albana Vokshi – Prisni, se do t'ju nxjerr edhe një herë intervistën

Milva Ekonomi – Unë besoj se në këto kushte ajo që kërkohet edhe nga vendet europiane, për një polici të denjë, policia duhet të marrë masa që edhe kur ka një protestë, të reagojë për të mbrojtur institucionet dhe protestat duhet të jenë proporcionale me mbrojtjen. Kështu që këto janë veprime, që duhet t'i kemi parasysh. Duke qenë kryeredaktor i një gazete të rëndësishme, unë e çmoj punën tuaj, por në këtë rast besoj se ndoshta ka qenë diçka që nuk e keni menduar mirë, që gazetari duhet të ishte i pajisur me ato mjete që duhet të ushtrojë punën, me bexhin, rripin e njohjes dhe duhet të ishte aty ku ishin gazetarët e tjerë, që mbroheshin nga policia. Edhe ju u përfshitë emocionalisht në këtë protestë si qytetar, por jo si kryeredaktor, sepse po të përfshiheshit si i tillë, me siguri që do të kishit bërë ato gjëra që jua kërkon manuali i gazetarit. Mendimi im është se ju nuk ishit gati për të qenë si gazetar në protestë, por si qytetar, si protestues aktiv.

Albana Vokshi- Po, Bledi.

Bledi Kasmi- Falënderoj deputeten për parashtrimin!

Dua ta nis nga pjesa e fundit lidhur me manualin e gazetarëve dhe do t'i lexoj vetëm një pjesë nga Udhëzuesi i Rishikuar për Sigurinë e Gazetarit, i cili është dokument ndërkombëtar, që nuk është as imi dhe as i shoqatave që janë këtu: “Gazetarët duhet të marrin përgjegjësinë për sigurinë e tyre, që nuk mund të lihet në dorë të tjerëve”. Do ta nis prapë nga pjesa e fundit juaja, që reagimi i forcave të policisë do të duhet të ishte në proporcion të drejtë edhe me sulmin apo me atë që ushtruan protestuesit. Cili është proporcioni i drejtë? Përballë vetëmbrojtjes me duar, t'u godisja me shkop hekuri kokës për t'u vrarë? Ky është proporcioni i drejtë?!

Milva Ekonomi –Policia nuk ka shkop hekuri.

Bledi Kasmi - Një sekondë, sepse ju dëgjova me kujdes. Cili është proporcioni i drejtë? Proporcioni i drejtë do të ishte ky: nëse kishte një dyshim ndaj meje, policia shumë mirë mund të më kishte marrë dhe të më kishte shoqëruar në komisariat. Ky do të ishte hapi i parë.

Cili do të ishte hapi i dytë? Mund të më godiste, por jo në vendet ku rrezikohet jeta e njeriut. Mund të më godisnin në këmbë, në krah, por jo në kokë, pasi goditja në kokë është për t'i marrë jetën njeriut. Unë uroj që asnjëri prej jush të mos ndodhet në atë pozicion. Është e vërtetë ajo që thatë ju, pse u ndodha aty, por hapini rrjetet sociale dhe keni emrin e një gazetareje, që ju e njihni shumë mirë, Desada Metaj, e ka postuar vetë foton e saj në rrjetet sociale, e cila është në rreshtin e parë, ku turma e protestuesve herë na shtynte dhe herë na zhvendoste. Gazetarët nuk kishin një vend të caktuar, ku mund të rrinin, sepse protesta u zhvendos disa herë nga njëri pozicion në tjetrin. Gazetarët herë dilnin në krahun e djathtë, herë pas gardhit të policëve dhe herë dilnin mes protestuesve. E tillë ishte protesta, nuk kishte rregulla, ishte kaotike dhe nga policia nuk kishte një kordon të qartë. Prandaj, them që nuk mund të justifikohet.

Unë nuk e di se si është urdhëruar dhe si ka goditur zotëria, përderisa nuk është identifikuar ende nga drejtësia, sepse, po të ishte identifikuar, mund ta kishit pyetur edhe atë ashtu siç po më pyesni mua, por fakti që merret në mbrojtje dhe nuk tregohet se kush është dhe fshihet, atëherë kjo merr pikëpyetje të tjera. Prandaj them se dënimi i dhunës nga ana e politikës do t'u shërbejë më mirë jo vetëm protestave paqësore, por edhe forcave policore, që, duke ndërmarrë akte të tilla, që mund të çojnë në pasoja fatale, mund të vendosin në rrezik stabilitetin e vendit nesër. Lus Zotin që sot jam gjallë dhe nuk kam pasoja për jetën, por po ju them që, nëse ajo goditje do të kishte qenë dy ose tre centimetra më lart, sikurse më kanë thënë vetë mjekët, atëherë do të kisha pasoja për jetën. A e kuptoni?

Faleminderit!

Milva Ekonomi - Ju uroj të shkuara, por ju jap një këshillë, kujdes me gjyzlykët, mos i mbani si unë në të tilla raste, sipër kokës.

Albana Vokshi – Çfarë po thua tani?! Pse, do të na mësoni ju se ku t'i mbajmë syzet? Genti, fjala për ju.

Gent Strazimiri – Faleminderit, zonja kryetare!

Me gjithë respektin për kolegët parafolës, veçanërisht për ata që janë thelluar te manuali i gazetarit, por më së shumti për ata që janë thelluar te manuali i policit, sepse të thellohesh te manuali i policit dhe të arrish në konkluzionin se Bledi Kasmi është dëmtuar atë

ditë në protestë se po ecte aksidentalisht përballë një shkopi që vinte në drejtimin e kundërt, unë besoj se është pak të thuash cinike...

Unë nuk kam luksin tuaj, që përmendni me gishta dore ata që i quani të dëmtuarit ndër vite, si, për shembull, të dëmtuarit e viteve 1994-1996 e të tjera me radhë, sepse unë duhet ta filloj nga 29 nëntori i vitit '44, ku 14600 vetë sot janë pa varr, që arithmetikisht i bie 311,111,111 çdo vit të qeverisjes suaj, sepse është juaja, pavarësisht se i ndërroni emrin.

Këtu unë jam një ndër deputetët, ndoshta jo i vetmi, me më shumë eksperiencë se një pjesë e kolegëve, përveç zotit Ulqini, i cili vjen nga gazetaria dhe ka shumë më tepër eksperiencë se unë, i cili nuk duhet të thoshte vetëm: “Ajo dita e tmerrshme e 14 shtatorit të vitit 1998”. Ajo ditë ishte e tmerrshme jo vetëm se u sulmua Televizioni, unë isha atje për ta mbrojtur, Musa, ndërsa ti nuk mund të vije, ishin 48 orë të tmerrshme, sepse ishte vrarë Azem Hajdari dhe ishte ai televizion që dëshmonte se vrasësit, që ishin oficerë të Policisë së Shtetit, nuk kishin lëvizur nga Tropoja ditën kur thoshte Sali Berisha dhe PD-ja. Gjithsesi, unë isha në shesh me drejtuesit, me ata që i kanë dhënë shpirtin, jo drejtuesit politikë të Televizionit, për të mbrojtur dhe për të ndaluar dufin e revoltës popullore. Pse nuk i pyet njerëzit pse shkuan te Televizioni atë ditë?! Sepse në tetor të vitit 1997 i ndjeri Azem Hajdari, i plagosur në parlament me një plumb në këmbë nga një koleg yti, Musa, i ndjeri Ylli Vejsiu, profesor, Vili Minarolli dhe profesor Shaban Memia kanë ndenjur 15 ditë në një makinë te dera e Radio-Tiranës për fjalën e lirë dhe më pas 20 e ca ditë ka bërë grevë urie Mandela e Shqipërisë, Pjetër Arbnori, apo edhe ai është njollë e zezë, sigurisht për të vetmin televizion, që ishte edhe imi edhe yti, se atëherë nuk kishte Top Channel. Atij televizioni nuk do t’ia thyej kush rekordin për zgjedhjet e vitit 2001, sepse nga raporti që ka dhënë OSBE-ja, 82,7% kohë kishte në dispozicion qeveria dhe nga pjesa e mbetur vetëm gjysmën opozita, sepse pjesën tjetër të kohës opozita përmendej në mënyrë pezhorative. Ti, sigurisht, i përmend këto si njolla të zeza, ndërkohë që njollë e bardhë për ty, për lëvizjen e lirë, për integrimin dhe për Shqipërinë europiane, Musa, është ajo makina atje, ku ndenjen 15 ditë, Azemi i plagosur bashkë me tre kolegët e tjerë, ndërkohë që ti ishe anëtar i Komisionit të Medias. Kur Pjetër Arbnori doli nga greva e urisë, pas 20 e ca ditësh, ishte një kufomë që ecte, sepse kishte ndenjur pa bukë dhe pa ujë, dhe ti e di që ajo ndoshta është e vetmja grevë urie e vërtetë në demokraci dhe ti, Musa, nuk shkove ta takoje. Këto janë njollat e bardha që ju keni në fytyrë. Çfarë njolle tjetër të bardhë të të përmend? Të përmend Griseldën, ditën kur do të liberalizoheshin vizat?! Kjo është njolla e bardhë dhe raportimi i të vërtetës? Kjo është të mos

i vësh njollë vendit?! Të të përmend “Çadrën”, kur do të hynim në NATO dhe do të liberalizoheshin vizat?

Si mund të thoni që ju vjen keq për Bledi Kasmin dhe të shikoni aq hollë, si një gjimnaziste e brishtë, duke prerë nga ERTV-ja sekuenca? Të jeni të bindur se, po të kisha qenë atje ku ishte Bledi, do të kisha bërë shumë më tepër për të mbrojtur Kastriotin, të cilit, me sa duket, aksidentalisht i ka rënë dielli në kokë dhe ka kaluar në lipotimi. Kastrioti është gjallë dhe mund t’ju thotë vetë se çfarë pati. Sigurisht që do të kisha bërë më shumë. Në qoftë se kjo është njollë e zezë për ne dhe e bardhë për ju, ju lutem shumë, në bazë të manualit të policisë, që e keni studiuar, me gjithë respektin që kam për ju, rikonsiderojini edhe një herë lëvizjet e policisë, veçanërisht të protestuesve më 21 janar. Bledi Kasmi, ky që atje ishte si protestues aktiv, nuk kishte një makinë që t’i binte mbrojtëses “Delta” të ministrisë 5 orë rresht. Në qoftë se doni të thelloheni edhe më shumë, ju mund të merrni dëshminë me zë dhe me figurë të ish-ambasadorit amerikan në Tiranë, Aleksandër Arvizu, nuk ishte tropojan, ju garantoj, nuk ka qenë as mik i Sali Berishës, edhe për këtë ju garantoj, i cili thotë: “Tjetër gjë thanë kur dolën në shesh dhe me tjetër axhendë vazhduan protestën. Po të kisha qenë një prej atyre policëve, do të kisha dalë nga radha dhe do t’i kisha rrahur”. Ky është dystandardi që keni me të vërtetën, me gazetarinë, me jetët e njerëzve, me ata që rrihen dhe me ata që vriten. Më vjen keq, sepse Musai nuk kuptohet me brezin tim, që jemi shumë afër, jo më të kuptohet me Kejdin, sepse në vitet 1990-1991, kur unë dhe disa të tjerë 18-vjeçarë në atë kohë, kërkonim Shqipërinë si e gjithë Europa, te gazeta “Zëri i Popullit”, që e drejtonte Musai deri në vitin 1995, thuhej se janë forca të errëta destruktive, të cilat kërkojnë të njollosin atdheun njësoj si Kadareja që dezertoi. Kjo është fjalë për fjalë, nuk keni nevojë për ERTV-në, mund të shkoni në Bibliotekën Kombëtare dhe e gjen, madje analiza e ditës ishte: “Mendimi largpamës i shokut Enver Hoxha, pikërisht në këto momente të vështira për socializmin, merr më shumë vlerë. Ju ftojme të rilexoni edhe një herë analizën e tij, imperializmi dhe revolucioni, eurokomunizmi është antikomunizëm, rreziku anglo-amerikan për Shqipërinë. Imperializmi edhe me një dhëmb po të ngelet, të kafshon”, shkruante Musai atëherë. Ky shkrim është i viteve 1992-1993, nuk po flas për më parë, ishin vitet kur kishte mundësi të ishte i lirë.

Në qoftë se po njollosni ende vendin me këtë fjalor dhe i keni vënë njollë të zezë, sigurisht që me këtë fjalor nuk merresh dot vesh me Kejdin, me brezin e saj dhe as me fëmijët e tu, Musa, që mund të jenë pak më të mëdhenj. Në qoftë se vazhdojmë në këtë mënyrë, ky vend mund të shpërthejë.

Musa, të përmenda njollat e bardha, sepse më përmende të zezat, ato të forcave destruktive dhe forcave të errëta, që duan të shkatërrojnë socializmin. Keni njollë pas njolle të bardhë, njësoj si ajo njolla e bardhë, që nuk jua nxin dot njeri, ministrin më të suksesshëm, Saimir Tahirin, herë në arrest, herë të lirë, për organizatë mafioze për trafik ndërkombëtar të drogës; pasardhësin e tij, subjekt i ligjit antimafia, që e keni bërë ju vetë dhe vazhdoni ta mbani. Këto nuk janë njolla jua ka vënë opozita, por ju ia keni vënë vendit dhe pastaj thoni se nuk do opozita, prandaj nuk hapen negociatat. Me njollë pas njolle të bardhë si kjo, Musa, 28 vjet rresht, jeni bërë të bardhë si kufoma. Largohuni, Musa, lëreni këtë vend të rrojë, sepse një kufomë nuk mund të japë frymë jete. Kjo është thirrja e fundit: të mos luajmë teatër këtu, Bledi Kasmi shtyn një polic për të ruajtur 64-vjeçarin, që ka rënë në tokë, dhe polici del nga rreshti i dytë, i gjuan dhe ju thoni që kjo është brenda manualit. Kjo nuk është brenda manualit. Makinën që futej te pengesa “Delta”, te Grada e Republikës për 5 orë rresht, nuk ma ke treguar. Manuali i policisë dhe i gazetarisë...

Milva Ekonomi - Është jashtë rendit të ditës, prandaj nuk jam përgatitur.

Genti Strazimiri – Jo, ishit përgatitur shumë mirë, madje më bëri shumë përshtypje, sepse ishit informuar aq mirë për manualin... Nuk e di se kë keni këshilltar. Ndërkohë që ju flisnit, mua më kujtoheshin disa gjëra, sepse kam punuar dhe kam shërbyer për dy vjet atje për shkak të detyrës dhe më është dashur t’i mësoj, por nuk i mbaj mend kaq mirë sa ju, ju jeni thelluar.

Në qoftë se kjo është e vërteta juaj dhe në qoftë se ju doni ta integroni kështu Shqipërinë... Europa, në radhë të parë, është e vërteta. Ai që gënjen nuk ka vend në Europë, veçanërisht kush ka një funksion publik. Nuk mund të marrësh montazhe e t’u thuash fëmijëve që Kastriot Hasku i ra diellit me kokë, prandaj u dëmtua, kështu shkruhet në regjistrin e mjekut të Beqajt, ndërsa Bledi Kasmi duhet të tregohet më i kujdesshëm herë tjetër, duhet të vërë një beixh dhe të shohë se ku i hedh këmbët, të mos i bjerë me kokë shkopit të policit, sepse polici e mban në dorë për shkak të manualit. Në qoftë se kjo është gjuha europiane, me të cilën thërrisni; në qoftë se kështu mendoni se zbardhni imazhin e vendit nga njollat që ne po i vëmë, e keni gabim, e keni jashtëzakonisht gabim. Sot po jua themi ne, por këtë e di çdo shqiptar dhe do të vijë shumë shpejt dita që ata do të çohen.

Për të mirën tuaj dhe tonën bashkë, për të mirën e këtij vendi, shikojeni të vërtetën në sy, mos përdorni fjalime që jua bën sektori i propagandës në Partinë Socialiste, sepse është turp. Këto që ne po flasim sot, një ditë do të dalin dhe do të shikohen pas disa vitesh dhe ju do të skuqeni. Kjo është njësoj si ajo gazeta “Zëri i popullit”, që nuk e lëviz njeri nga

Biblioteka Kombëtare, është atje dhe tregon qëndrimin e secilit prej nesh në lidhje me Europën, me Amerikën, me integrimin dhe tregon se kush e ka aspiratën për fjalën e lirë, ekonominë e tregut dhe, sigurisht, për demokracinë.

Faleminderit!

Albana Vokshi –Faleminderit!

Musa Ulqini –Dua të flas unë...

Albana Vokshi- Jo, nuk mund ta merrni fjalën disa herë, të lutem!

Musa Ulqini – Ju lutem, 30 sekonda, sepse, sipas Rregullores, kam të drejtë, pasi ma ka përmendur emrin 5 herë.

Albana Vokshi – Nuk mund ta marrësh fjalën gjithmonë, nuk e bën dot personale.

Musa Ulqini- Kryetare, e vendos Rregullorja.

Albana Vokshi – Do t’ia jepja fjalën koleges tënde.

Musa Ulqini –Nuk mund të flasë kolegia.

Albana Vokshi – Kur e do Rregulloren, e lexon, kur nuk e do, nuk e lexon.

Musa Ulqini – Kam të drejtën e fjalës për replikë.

Albana Vokshi – Dakord, vazhdo.

Gent Strazimiri – Rregullorja për komisionet nuk shprehet, nuk kuptohet, zoti Ulqini. Ju lutem lëreni të flasë dhe ju lutem më krijoni të njëjtën mundësi t’i kthej përgjigje.

Albana Vokshi – Patjetër. Doja vetëm t’ju kujtoj se Rregullorja nuk lexohet siç i intereson Musait.

Musa Ulqini – Jo, nuk futem në atë grup.

Albana Vokshi – Merre dhe lexoje mirë Rregulloren!

Musa Ulqini – E para, parafolësi...

Albana Vokshi – Rregullorja nuk ka replikë, por thotë që e drejton kryetarja.

Musa Ulqini – Jo, ka replikë. A ka mundësi të flas?

Albana Vokshi – Merre, hape dhe lexoje!

Musa Ulqini – E para, parafolësi, çfarëdo që të thotë për mua, nuk më nxin dot, sepse janë 28 vjet që flasin vetë.

E dyta, në qoftë se e fillon me luftën, unë jam krenar që kam qenë dhe jam në mënyrë ideologjike në anën e tyre që luftuan për çlirimin e Shqipërisë dhe jo si zotëria në fjalë që është në anën e atyre që punuan dhe luftuan me bashkëpunëtorët, me gjermanët...

Tjetra, në qoftë se ai kërkon të dijë se kur kam ikur nga “Zëri i Popullit”, pyet atë zotërinë, unë kam ikur në vitin 1990 dhe kam qenë gazetar i thjeshtë i ZP-së, dhe jo gazetar

special, si babai i atij djalit te “Zëri i popullit”. Në qoftë se ai djali atje, ai zotëria, më thotë, mua t’i jap shpjegime për të vrarët nga diktatura...

Albana Vokshi – Kur nuk keni argumente, merreni me biografinë e kohës së Enver Hoxhës...

Musa Ulqini – T’ia kërkojë Sali Berishës...

Albana Vokshi – Po, do t’i kërkojë...

Musa Ulqini – T’ia kërkojë Sali Berishës pse nuk e ka bërë atë gjë dhe jo Musa Ulqinit. Pra, Sali Berishës, i cili ka qenë një nga njerëzit e nomenklaturës së lartë komuniste. Dakord?! Atij t’ia kërkojë, pastaj të ma kërkojë mua...

(Reagim pa mikrofon.)

Unë thashë në datën...

Albana Vokshi – Sali Berishën e vlerëson historia, o Musa Ulqini, se nuk ka mbetur ta vlerësosh ti...

Musa Ulqini – E di, pra, e di. Jo, në datën 28 qershor, thashë që kjo është njollë turpi. Kjo është e regjistruar dhe ju nuk e zhbëni dot këtë që ka ndodhur më 28, që është njolla juaj e turpit.

Albana Vokshi – Më 28 kur?

Musa Ulqini – Më 28 maj të vitit 1996...

Albana Vokshi – Kur ju tërhoqët komisionierët me urdhër?! Kur tërhoqët ju komisionerët?

Musa Ulqini – Ajo që thatë për RTSH-në kishte një kuptim tjetër, pra thatë se ju shkuat ta çlironit RTSH-në nga punonjësit e saj. Një turp i madh! Ajo që thotë zotëria për grevën e urisë, unë kam qenë interlokutori kryesor i asaj partie atëherë, që kam bashkëpunuar me një njeri shumë të nderuar, të cilit ky dhe disa shokët e tij nuk i vijnë as të gishti i këmbës së vogël. Një njeri që ka bërë 28 vjet burg dhe që ka qenë shembulli se si duhet të ndërtohet e ardhmja e këtij vendi! Unë kam qenë atje, se thotë që nuk ka qenë Musai.

E fundit fare, unë kam ikur një ditë nga gazeta “Zëri i Popullit”, pasi është botuar...

Albana Vokshi – Pse të djeg ty?

Musa Ulqini – Nuk më djeg fare, vetëm po jap sqarime...

Albana Vokshi – Mos të djegë kaq shumë. Ke qenë gazetar i “Zëri të Popullit” i bindur para dhe pas...

Musa Ulqini – Jo, sepse shpif...

Qymyri të nxin, moj kryetare! Qymyri i zi të nxin. Shpif, lë gjurmë. Unë po them se kam ikur nga “Zëri i Popullit” një ditë pasi është botuar një shkrim i bashkëpunëtorit tim për 31 majin, Ditën Ndërkombëtare të Luftës kundër Duhanit, shkrimi më i mirë që bashkëpunëtori im i 5 vjetëve, Sali Berisha, ka botuar në “Zërin e Popullit”, pa diskutim, më i miri, që kishte edhe konotacion politik. Atë ditë kam ikur nga “Zëri i Popullit” dhe i jam bashkuar kësaj partie që atë ditë e deri më sot dhe jam krenar që jam pjesë e kësaj partie. Jam krenar për historinë time dhe ai zotëria atje ta lajë gojën nga mëngjesi deri në darkë, sepse nuk më njollos mua me asgjë, as më krim, as me korrupsion, as me fjalor, as me shpifje, as me sjelljen, se është vite dritë larg meje. Kaq.

Albana Vokshi – Po, Genti.

Gent Strazimiri – Zonja kryetare, më duhet të saktësoj: e para e punës, krenaria nuk di nga i buron zotërisë më parë. Unë di të them se unë vetë i jam mirënjohës Zotit, sepse është një gjë që nuk e zgjedhim, ta jep Zoti, që të parët e mi i kam pasur gjithmonë në anën e duhur të historisë. I kam pasur antifashistë, aq sa i kam dhe i kam pasur që ditën e parë antikomunistë. Ajo për të cilën zotëria është krenar, nuk është lufta, por është nga mëngjesi i 29 nëntorit ’44 e mbrapa, është paqja. E gjithë lista e firmëtarëve të Pavarësisë, kanë dalë bashkëpunëtorë të fashizmit, bashkëpunëtorë të cilitdo. Kjo është arsyeja për të cilën ti je krenar dhe këtu ndahemi me njëri-tjetrin.

Për sa u përket të gjitha të tjerave, në qoftë se edhe këto të vërteta që unë thashë.... U përpoqe të distancoheshe nga ZP-ja, nuk distancohesh dot... Në konceptimin tim, është krim edhe më i madh të mbrosh trafikantët e drogës, të prostitutave, të mbrosh vrasësit dhe kriminelët në parlament, por të mbrosh ministrat narkotrafikantë është krim po aq i rëndë. Prandaj, Kejdi, mos insisto më, nuk merresh dot vesh me ta. Ti dhe brezi yt duhet t’i ndryshojë...

Ju faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Adelina Rista – Kam fjalën.

Klevis Balliu – Jo, e kam unë fjalën, se më përmendi familjen...

Adelina Rista – Jo, nuk të përmendi fare...

Albana Vokshi – Adelina, vetëm një replikë 30 sekonda...

Adelina Rista – Përdore në fjalën tënde, ty nuk të përmendi as emër, asgjë.

Klevis Balliu – Më përmendi familjen, moj zonjë!

Adelina Rista – Nuk të përmendi. Fol kur të kesh fjalën...

Albana Vokshi – 30 sekonda replikë...

E përmendi dhe jo një herë...

Adelina Rista – Le të flasë, kur të ketë fjalën...

Albana Vokshi – Klevis, 30 sekonda replikë, pastaj do të jap fjalën...

Adelina Rista – Kur të ketë fjalën, pse duhet ta thyejmë ne Rregulloren?...

Albana Vokshi – Adelina, të lutem, tani, se jam unë këtu! Ku e keni mendjen? Mos flini gjumë!

Adelina Rista – Nuk ia përmendi...

Albana Vokshi – E përmendi 100 herë.

Adelina Rista – Kur të ketë fjalën, le të flasë...

Albana Vokshi – E drejtoj unë. 30 sekonda...

Klevis Balliu – Ia lëmë...

(Reagim pa mikrofon.)

Me qetësi! Mjafton ta kërkos, moj zonjë! Nuk ka nevojë të lemerisesh! Nuk jeni këtu te partia juaj.

Albana Vokshi – Klevis, 30 sekonda replikë, pastaj të jap fjalën.

Klevia Balliu – Është bërë pak e shpeshtë....

(Zoti Ulqini ndërhyr pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Lërë, more tani! Turp i madh!

(Zoti Ulqini ndërhyr pa mikrofon.)

Klevis Balliu – E di sa larg je ti me familjen time, apo jo?! Politikisht, je shumë i vogël...

(Reagime pa mikrofon.)

A ka mundësi ta mbaroj unë?

Albana Vokshi – E fole, e përmende, dëgjoje! Klevis, 30 sekonda, ta jap pastaj fjalën. Mos i kthe përgjigje.

(Zoti Ulqini ndërhyr pa mikrofon.)

Pse po e banalizon kaq shumë, o Musa?

Musa, ti i bërë biografinë, lërë të flasë tani!

(Zoti Ulqini ndërhyr pa mikrofon.)

Hesht, të flasë ai! Vazhdo!

(Zoti Ulqini ndërhyr pa mikrofon.)

Kujdes! Mbaje fjalën! Mbaje fjalën!

Musa Ulqini – Si ta mbaj fjalën?!

Albana Vokshi – Mos fyej! Mos fyej, se është turp! Po fyesi të gjithë me radhë!
Mbaj fjalët! Mbaje gojën, mos fol! Boll!

(Zoti Ulqini ndërhyr pa mikrofon.)

Boll, pra!

Unë nuk bie në batakun që keni rënë ju, që vetëm shani!

Musa Ulqini – Simboli i provokimeve! Simboli i antirregullores....

Albana Vokshi – Boll, mos fyej! Nuk është argument fyerja! Nuk është argument biografia!

(Zoti Ulqini flet pa mikrofon.)

Klevis Balliu – O Musa, kaq frikë ke nga kjo që them unë?!

Albana Vokshi – Si nuk ju vjen turp?!

Musa Ulqini – ...si nuk duhet të drejtosh një komision.

Albana Vokshi – Kur më shan ti, unë jam politikisht korrekt, jam e nderuar. Kështu që hesht!

Klevis Balliu – O Musa, kaq frikë ke nga kjo që do të them?! Ke ngelur te emrat... Në 7 komisione “Fariu, Fariu...” Ka 27 vjet që i pret të gjithë me radhë, t’i dalin përballë, nuk i del njeri.

Albana Vokshi – Vazhdo Klevis!

Klevis Balliu – Edhe në qoftë se...

(Zoti Ulqini ndërhyr pa mikrofon.)

Kanë zero interes.

(Zoti Musa Ulqini flet pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Me qetësi, të lutem! Mos bëj zhurmuesin kot tani!

Klevis Balliu – Nuk më intereson, o Musa, as kur ke hyrë, as kur ke dalë.

Albana Vokshi – Të fillojmë me babanë dhe nënën tënde tani?!

Klevis Balliu – O Musa, kaq frikë ke që nuk më lë ta mbaroj unë fjalinë?!

Musa Ulqini – Unë frikë?!

Unë nuk kam pasur frikë atëherë kur...

Klevis Balliu – Atëherë, prit të mbaroj.

Albana Vokshi – Klevis, do të flasësh apo t’ia kaloj fjalën Adelinës?

Klevis Balliu – Albana, unë do të flas, por, ashtu siç flet ai, mund të flas 12 orë duke folur dhe nuk mbaron njeri punë.

(Zoti Musa Ulqini flet pa mikrofon.)

Musa, nuk më intereson as kur ke hyrë, as kur ke dalë, fare, zero, as për ty dhe as për njeri tjetër! Por fakti që në kulturën tuaj nuk u shkëputkeni dot, pra që më keni mua përballë dhe duhet të merreni me familjen time! Kjo ka qenë pjesë e trurit tuaj.

(Zoti Ulqini ndërhyr pa mikrofon.)

M'u drejtove mua dhe nuk je i pari. E keni të gjithë si kulturë: merreni me biografinë, merreni me biografinë, merreni me biografinë! E keni tuajën.

Musa Ulqini – Jam me fat!

Klevis Balliu – Më ke mua përballë dhe merresh me biografinë.

Albana Vokshi – Musa, të dëgjuam, tani hesht! Ki pak respekt!

Klevis Balliu – Ti e di shumë mirë që edhe te kjo tryezë, po t'i futem edhe unë me nënë dhe me baba, këtu dalin xhelatë. A më kupton?

(Zoti Musa Ulqini flet pa mikrofon.)

Musa Ulqini – Jepi përgjigje pyetjes sime.

Klevis Balliu – Ti e di më mirë se unë këtë punë, që, po t'i futem, dalin xhelatë te kjo tavolinë.

(Zoti Ulqini ndërhyr pa mikrofon.)

Albana Vokshi – O Musa, boll, respekto! Mos bëj kot zhurmuesin!

Musa Ulqini – Përgjigju pyetjes sime!

Albana Vokshi – Lërë të flasë, se ka marrë fjalën!

Musa Ulqini – Jo, jepi përgjigje pyetjes sime.

Albana Vokshi – Ore, mos i jep përgjigje ti, Klevis!

Klevis Balliu – Mua nuk më intereson as kur ke hyrë, as kur ke dalë. Nuk më intereson fare kjo. Ke pasur punët e tua.

Albana Vokshi – Vazhdo Adelina.

(Zoti Musa Ulqini flet pa mikrofon.)

Klevis Balliu – Nuk kam punë fare. Nuk më intereson as kur ke hyrë, as kur ke dalë. Nuk ka lidhje me mua kjo.

Albana Vokshi – Fjalën e ka Adelina, sa të qetësohet Musai.

Musa Ulqini – Nuk ka lidhje, le të flasë.

Albana Vokshi – Ndërkohë, qetësohu! Të lutem! Vazhdo, Adelina!

(Zoti Musa Ulqini flet pa mikrofon.)

Ki respekt për kolegen tende, të paktën, sepse e ka kërkuar fjalën që në fillim.

Adelina Rista – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, unë distancohem nga komunikimi jokorrekt mes kolegësh në komision, nuk është hera e parë dhe unë them se nuk do të jetë as e fundit. Tashmë është kthyer në model ky lloj komunikimi në komisionin tonë. Megjithatë statusin e kemi Komisioni i Edukimit dhe Medies, vetëm edukim nuk përcjellim ne me komunikimin tonë nga kjo foltore, nga foltorja e komisionit. Mua, sinqerisht, me vjen keq për këtë. Ndaj, distancohem, dhe distancohem fuqishëm, nga ky lloj komunikimi.

Unë këmbëngul, në mendimin tim, se ky lloj komunikimi e ka një shkak dhe shkakun është mosmbajtja e rregullit në drejtimin e komisionit; mosmbajtja e rregullit në të drejtën e fjalës që ka gjithsecili prej nesh...

Albana Vokshi – Fol për dhunën tani!

Adelina Rista – Të lutem!

Albana Vokshi – Ky shan, ti thua “mbaj rregullin”.

Adelina Rista – Edhe kjo sharja juaj është dhunë verbale në të drejtën e të folurit që ka secili. Ju lutem, nuk ka të drejtë askush të ndërhyjë në fjalën e tjetrit. Duke ndërhyrë në fjalën e tjetrit, kalon në debat. Unë kam të drejtën e fjalës. Ne e kemi dhënë modelin tonë. Dëgjojmë shumë mirë kur ju, zotërinj, përballë flisni. Të njëjtin model kopjojeni, në qoftë se jeni kopjacë... Nëse s'mund të kopjoni modelin tonë, përmbani veten dhe dëgjoni. Dëgjoni të paktën për edukatë, sepse jeni në Komisionin e Edukimit. Dëgjoni, ashtu siç ju dëgjojmë ne. Është gjëja më elementare. E, pra, dëgjoni!

Thashë që distancohem fuqishëm nga ky lloj modeli komunikimi.

E dyta, i dua dhe i respektoj njerëzit e lexuar dhe të penës, shumë. Kam respekt për ta. Këtu fus edhe gazetarët që bëjnë gazetarinë e vërtetë. Kam respekt të pakufishëm për ta, sepse sot ndeshemi jo rrallë, por shpesh vetëm me ashtuquajturit gazetarë, por që nuk dinë të bëjnë gazetari ose e ndotin atë. E pra, unë e dua gazetarinë e vërtetë dhe i respektoj në maksimum gazetarët e vërtetë. Është një profesion shumë i bukur, por aq sa është i bukur, është edhe i vështirë. Pikërisht, për vështirësinë që kanë, gazetarët duhet të mbështeten fuqishëm, aq më tepër edhe nga ne që jemi Komisioni i Edukimit dhe Medies.

Protesta, miqtë e mi, kolegë deputetë, është institucioni që vërteton më së miri se demokracia funksionon në shtetin demokratik. Secili prej nesh çdo ditë ka diçka për të protestuar...

Albana Vokshi – Përsërite edhe një herë të lutem, ta mbajmë shënim këtë që the...

Adelina Rista – Të lutem, secili prej nesh ka diçka për të protestuar çdo ditë. Është e drejtë e çdokujt të protestojë, por unë distancohem dhe jam kundër përdorimit të dhunës e mjeteve të dhunës, dhe të çdolloj force në një protestë paqësore. Në këtë këndvështrim, gazetar i nderuar, unë ju uroj, ju dëgjova me vëmendje, shërim të shpejtë! Uroj që ju t'i riktheheni detyrës suaj si gazetar në gazetarinë e vërtetë. Ju dëgjova me vëmendje, ndaj desha që në fillim t'ju bëj një pyetje. Megjithëse janë bërë shumë diskutime, unë përsëri do ta bëj pyetjen time, sepse pyetjet janë në funksion të qartësimit, që pastaj të zhvillohet diskutimi.

Prandaj, zonja kryetare, jam gjithmonë e mendimit që gjithmonë pas një dëgjese, ne të bëjmë pyetjet dhe, pasi të marrim përgjigjet e pyetjeve, të kalojmë në diskutime, sepse pyetjet na ndihmojnë të qartësohemi për të ndërtuar fjalën tonë dhe për të dhënë gjykimin sipas këndvështrimit tonë. Unë do ta bëj pyetjen time, i nderuar gazetar. E kam gati.

(Kryetarja e komisionit ndërhyr pa mikrofon.)

Duhet të dini që unë nuk jam nga ata, Albana, besoj se më njeh. Jam vetvetja në çdo gjë. Këtu kam dy gazetarë. Njëri është i kronikës dhe tjetrit është i politikës, të cilët po e pasqyrojnë atë ditë protestën, po bëjnë detyrën e tyre si gazetarë, në respekt të punës dhe detyrës së tyre si gazetarë.

(Kryetarja e komisionit ndërhyr pa mikrofon.)

Të lutem, ta mbaroj unë fjalën, pastaj bëj pyetje. Ke të drejtën të pyesësh, por kur të mbaroj unë. Dakord? Të mbaroj unë dhe bëj pyetje sa të duash, por të mbaroj unë një herë!

Ashtu pra!

Këtu janë gazetarët, të cilët bënë detyrën e tyre si gazetarë në terren dhe pasqyruan protestën...

(Kryetarja e komisionit ndërhyr pa mikrofon.)

Të lutem!

(Deputetja Rista shfaq pamjet video të protestës.)

Ja, urdhëro, po bëjnë detyrën e tyre si gazetarë, duke pasqyruar protestën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, që të dal te pyetja ime!

Jini më i duruar, sepse unë ju durova gjithë kohën!

Dua të dal te pyetja ime edhe për ju.

(Deputetja Rista rishfaq pamjet video nga protesta.)

Këtu jeni ju dhe nuk ju shoh duke bërë detyrën e gazetarit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem tani!

Unë jam...

Jo, të lutem, Albana, edhe një herë po ta them, me mua nuk të shkojnë këto! Vetëm me mua jo!

Aspak, unë jam vetvetja.

(Debat në sallë.)

Më lër të flas.

(Kryetarja e komisionit flet pa mikrofon.)

Të lutem!

Albana Vokshi – ...po u binte në kokë rrjeta dhe po shkeleshin qytetarët!

Adelina Rista – Ta mbaroj, zonja kryetare, të lutem!

Albana Vokshi – Ai po bënte detyrën aty.

Milva Ekonomi – Çfarë detyre po bënte? Detyra ishte të raportonte.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – Të mbaroj për atë që më ka ndërhyrë, pastaj do të flas!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Do të ta shpjegoj, mos ki merak!

Adelina Rista – Të lutem tani, se jam te pyetja!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më lër t'ia bëj pyetjen, pra!

Albana Vokshi – Po flet tjetri.

Adelina Rista – Nga ai e kërkoj.

Albana Vokshi – Sigurisht, nga ai, se prandaj e kemi ftuar.

Adelina Rista – Po, pra!

Albana Vokshi – Ftoni edhe ata të tjerët juve.

Adelina Rista – Tani, i nderuar, ju jeni gazetar. Unë ju dëgjova me vëmendje. Unë, si popull, nuk ju njoh që jeni gazetar. Unë që ju shoh nga ekrani, nuk ju njoh për gazetar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

Bledi Kasmi – As unë nuk ju njoh si deputete...

Adelina Rista – Jam pas ekranit.

Bledi Kasmi – Por kjo nuk ka lidhje fare.

Adelina Rista – Nuk ju njoh si gazetar.

Bledi Kasmi – As unë nuk ju njoh si deputete.

Adelina Rista – Të mbaroj, ju lutem, pastaj ma jepni përgjigjen!

Mos më njih mua si deputete kurrë, nuk më intereson fare. Unë jam populli që po shoh ekranin dhe po shoh protestën, dhe këtu po flas si një prej atyre që po ndjekin pas ekranit protestën. Dua të di, ku ndahesh këtu nga gazetari, nga demonstruesi aktiv?

Pyetja e dytë që kam, ju jeni gazetar dhe ishit aty, kështu thatë, se po bënit punën e gazetarit. Në fjalën tuaj dëgjova, se ju, si gazetar që informoni publikun, edhe këtu po na informoni neve, ishit aty në mbrojtje të një protestuesi që ra në tokë dhe të tre të tjerëve, me gjithë ju katër, të cilëve ju uroj singërisht shërim të shpejtë, por nuk dëgjova nga ju të thoshit: hynë policët te populli dhe te ju protestuesit, apo shkuat ju te kordoni i policisë?

Këtë nuk e dëgjova.

(Diskutime në sallë.)

Nuk dëgjova nga ju, si gazetar, përsëri të thoshit në këtë komision të nderuar, në këtë dëgjese me anëtarët e Komisionit të Edukimit dhe Medias, ku ju kemi thirrur dhe ne kemi ardhur të gjithë këtu bashkë: a u goditën policët dhe a pati të plagosur nga policia? Si gazetar, që informoni publikun dhe ishit aty për të bërë detyrën, ju duhet të keni parë edhe policë të rënë në tokë apo patë vetëm protestues të rënë në tokë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, zotëri, se nuk po jua drejtoj juve pyetjen!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në qoftë se ju informoni publikun, a duhet të jetë i paanshëm informimi juaj, si gazetar?

Respekt për ju! Shërim të shpejtë!

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Po, zoti Velaj, kishit një pyetje.

T'i mbledhim pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Cilën do? E kam unë, por më duhet.

Fidel Ylli – Ta jap prapë.

(Deputeti Velaj flet pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Pyete, pra!

(Deputeti Velaj flet pa mikrofon.)

Të lutem, me mikrofon, se nuk regjistrohet pyetja.

Fatmir Velaj – Edhe një herë, lexova artikullin tuaj dhe dua të bëj një pyetje: Fatos Mahmutaj bën pjesë te puçistët në këtë...?

Bledi Kasmi – Jo, absolutisht jo!

Fatmir Velaj – A keni mbajtur qëndrim ju atëherë për vrasjen e Fatosit?

Bledi Kasmi – Patjetër që kemi mbajtur, kemi thënë të vërtetën, me përjashtim të...

Fatmir Velaj – I thirrë ata që goditën...?

Bledi Kasmi – Një minutë, ta mbaroj.

Fatmir Velaj – I thirrë ata që goditën këtu? Bëre ndonjë kërkesë që të vini këtu?

Bledi Kasmi – Unë nuk thërras njeri...

Albana Vokshi – Bledi nuk është deputet.

Bledi Kasmi – Unë nuk kam të drejtë të thërras njerëz këtu.

Fatmir Velaj – Jo, desha të them, e propozove, siç e propozuam ne për të tjera...?

Bledi Kasmi – Nuk kam të drejtë propozimi, absolutisht. Unë kam qenë si gazetar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Një minutë, të lutem!

E bëmë ne kërkesën, por merr vesh pak procedurat!

Fatmir Velaj – A bëni pjesë tek Unioni i Gazetarëve?

Bledi Kasmi – Po, në Unionin e Gazetarëve, kurse në unionin e policisë së gazetarëve nuk bëj pjesë.

Fatmir Velaj – Pak rëndësi ka, por në njërin nga këto.

Bledi Kasmi – Patjetër që jam pjesë.

Fatmir Velaj – A keni firmosur ju për dhunën ndaj Fatosit?

Bledi Kasmi – Patjetër që kam firmosur.

Fatmir Velaj – I shkuat ju në spital, siç ju erdhën juve?

Albana Vokshi – Ç'i keni këto tani?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta tregoj unë spitalin, se kam shkuar vetë.

Bledi Kasmi – Zoti deputet, të njëjtat pyetje që po më bëni ju, mund t'jua bëja edhe unë juve në atë kohë, se edhe juve keni shkruar në atë kohë për RD-në. A shkoje ti atëherë te Mahmutajt atje?

Në lidhje me...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatmir Velaj – Nëpërmjet një miku ai donte të fliste *live via Skype*, por unë i thashë jo, se nuk është edhe vendi.

Albana Vokshi – Kujdes, se na trembët tani, *via Skype*! Nxirre pra, *via Skype*, ose sille këtu!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, Bledi, a mund t'i përgjigjesh?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord, mbledhim pyetjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ke pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo, pyetjet në fillim.

Klevis Balliu – Kam vetëm një pyetje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nuk ka gjë. Media vazhdon dhe kush të dojë, na ndjek.

Po, zoti Balliu.

Klevis Balliu – Kam vetëm një pyetje, zoti Kasmi. A erdhi ndonjëri nga deputetët e maxhorancës t'ju pyeste: “Si jeni? Si kaluat? A u vratë, a nuk u vratë? A ju dëmtuan, a nuk ju dëmtuan?”, sepse, për shembull, disa të opozitës shkuan edhe te Policia e Shtetit, që, pavarësisht se të gjithë kishim disa goditje emocionale më shumë, pasi ishin të gjitha të brendshme, nuk i shihnim ndonjë plagë sipër, por gjithsesi njeriu e vuan nga brenda emocionin e protestës. Pra, a ju vizitoi ndonjëri nga deputetët e maxhorancës?

Bledi Kasmi – Jo, fatkeqësisht, nuk ka ardhur asnjë person.

Klevis Balliu – Faleminderit për përgjigjen!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po.

Bledi Kasmi – Tani, kam një përgjigje të shkurtër për zonjën deputete.

Albana Vokshi – Për pjesën e dhunës.

Bledi Kasmi – E nderuara deputete, ju falënderoj për pyetjen dhe parashtrimin që bëtë! Unë jam rritur, jam edukuar dhe kam studiuar gazetari jo vetëm në Shqipëri, por edhe në vende të tjera, dhe leksioni kryesor që më kanë dhënë kudo ku kam qenë ka qenë: gazetari duhet të jetë në vijën e parë të frontit dhe jo në prapnicën e pushtetit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë i respektoj të gjithë gazetarët për zgjedhjen që kanë bërë. Kjo është zgjedhja që kam bërë unë dhe kam qenë aty si gazetar. Në momentin kur agresioni i policisë ka rrezikuar jetën e njerëzve, kam bërë vetëmbrojtjen që do të kishe bërë edhe ti po të ishe në pozicionin tim.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Adelina...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dua të tregoj vetëm diçka. Unë e kam shoqëruar Bledin me ambulancë dhe e kam dërguar në spital. Meqenëse ishte...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Fakti ishte që ju i bëtë fotografi.

Albana Vokshi – Bëja fotografi që ju të mos zhdukni provat.

Milva Ekonomi – Nuk e shoqërova...

Albana Vokshi – E kam shoqëruar, Milva, kam qenë në ambulancë, mund të të tregoj fotot edhe në spital.

Kam bërë edhe...

Po, po, pa merak, e kam bërë edhe atë!

Milva Ekonomi – Nuk ishte ndonjë rast aq i vështirë për të mos u mbajtur mend ai, se po e shikonin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të gjitha stacionet televizive e jepnin protestën dhe ne po e shikonim!

Albana Vokshi – Milva, të lutem!

Dua të tregoj vetëm një fakt, që, në fakt, nuk e kemi thënë më përpara. Meqenëse Bledi po mjekohej, po qepej, ka pasur një çarje shumë të madhe, unë i kam ndenjur te koka gjithë kohën kur e kanë vizituar, pastruar, kur e kanë qepur. E ka pasur aq të madhe, sa i kanë bërë dhjetë qepje në kokë dhe nuk ishte e mundur t'u përgjigjej telefonatave në atë kohë, sepse nuk ishte mirë. Kështu, telefonin e menaxhoja unë në njëfarë mënyre, sepse duhej t'u përgjigjej telefonatave të familjes, të gruas që ishte e tronditur.

Kur kam hapur faqen e Facebook-ut të Bledit, ka qenë raportimi i fundit dhe meqenëse është goditur në kokë, nuk kishte mundur ta dërgonte apo edhe t'i jepte “Send” postimit të fundit.

Unë mendoj se kjo është vërtetim i asaj që Bledi ka qenë duke raportuar në kohë reale atë çfarë po ndodhte. Nuk ka lidhje me dhunën, sepse, vërtet nuk shihet, sado aty shihet se vetëm po shtyn rrjetat për të mbrojtur të tjerët; as ka goditur policët, as ka ngritur dorën kundër një polici, as ka ushtruar dhunë ndaj një polici!

Ne po kërkojmë të hetohet. Pse nuk hetohet? Pse nuk ka policia hetim administrativ? Pse e fsheh policin që ka ardhur nga rreshti i dytë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – Albana, të lutem!

Albana Vokshi – Jam dëshmitare, Adelina!

Adelina Rista – Ti e di që unë jam konçize dhe tepër e qartë në këtë...

(Deputetet Vokshi dhe Rista flasin njëkohësisht.)

Tani po të them edhe një herë...

Albana Vokshi – Por më dëgjo edhe mua, se po të tregoj unë!

Adelina Rista – Pyetjen e bëra shumë të saktë dhe shumë konkrete.

Albana Vokshi – Edhe përgjigjen e more shumë të saktë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – Jam publiku, po shoh në ekran...

Albana Vokshi – Çfarë sheh në ekran?

Adelina Rista – Në ekran nuk të dalloj dot ty...

Albana Vokshi – Që po mban rrjetën e telit?!

Adelina Rista – ...që je gazetar.

Madje i thashë zotërisë: ku ndahet, për mua si popull që po të shoh, gazetari nga demonstruesi aktiv në këtë pamje?

Albana Vokshi – Nuk e ndan ti këtë.

Adelina Rista – Këtë pyetje bëra.

Albana Vokshi – T'i ftojme organet? Nuk e ndan ti këtë.

Adelina Rista – Se unë nuk e dalloj dot kush është gazetar.

Albana Vokshi – Ti je subjektive, nuk e ndan dot ti!

Adelina Rista – Ta konkretizova.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo pra, është ai që sheh, është publiku. Unë jam në këndvështrimin e publikut.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Unë isha aty dhe e pashë.

Adelina Rista – Unë atë pyetje bëra dhe e mora përgjigjen.

Faleminderit zotërisë!

Albana Vokshi – Unë dola në vijë të parë papritur e pa kujtuar.

Adelina Rista – Unë e falënderova!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Shyqyr!

Fjalën e kanë kërkuar zonja Duka, zoti Beqiraj dhe zoti Balliu në fund, pasi do të më duhet ta mbyll, sepse kjo pjesë mori shumë kohë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Tani, le të tërhiqet dikush, sepse edhe nuk po na ndjek dot njeri në këto momente.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valentina Duka – Jo, jo, në fakt, po na incizojnë.

E para, dua ta falënderoj zotin Kasmi që iu përgjigj pozitivisht kërkesës sonë për të qenë në komision dhe i uroj shërim të shpejtë, pasi, siç e thashë edhe radhën e parë, e kam pasur edhe student shumë të mirë në degën “Gazetari”!

E dyta, dua të falënderoj Organizatën shumë prestigjioze të Reporterëve pa Kufij, të cilët mendoj se i njohin më mirë sesa ne manualët e gazetarisë dhe që menjëherë në *Twitter*-in e tyre, duke parë skenat, i kërkuan Kryeministrit të Shqipërisë të dënojë dhunën ndaj gazetarit që u godit në krye të detyrës!

E treta, dua të falënderoj edhe Organizatën e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë, të cilët, gjithashtu, si Reporterët pa Kufij, kërkuan që Kryeministri, qeveria shqiptare, deputetët këtu, të këtij komisioni shumë prestigjioz, të dënojmë dhunën kundër gazetarëve!

Gjithashtu, më vjen shumë keq që ju na sollët këtu ballinën e gazetës “Rilindja Demokratike” të para pesë vjetëve! M’u krijua përshtypja sikur ju nuk harroni, por mbani shënime për të gjithë ata që ju kanë kundërshtuar juve që, kur të vinte dita, të hakmerreshit ndaj tyre. Mënyra se si ju e sollët ballinën e RD-së këtu, mua dhe shumë deputetëve, na krijuat përshtypjen sikur e sollët për t’i treguar Bledit: “Ke shkruar kështu para pesë vjetëve, prandaj e meritoje këtë dhunë!”, që është e pafalshme dhe e turpshme që kjo të ndodhë pikërisht në Komisionin e Edukimit.

E katërta, meqenëse kam edhe deputetët e Vlorës këtu dhe u fol shumë për historinë, dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj një anekdotë të vitit 1912, kur filloi të zinte rrënjë shteti Shqiptar. Po e sjell nga Ismail Qemali, se e doni shumë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E duam të gjithë, sepse është nga Vlora.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Absolutisht, edhe unë e dua shumë, madje edhe e studioj.

Ismail Qemali, kur i dha detyrën kryetarit të xhandarmërisë, një vlonjati të mirë e të mençur, i tha: “Vish shpejt rrobat dhe hajde të marrësh detyrën”. Ai veshi rrobat dhe kur i doli Ismail Qemalit para, kishte mbushur të gjitha jakat e këmishës së tij me yje. Ismail Qemali tha: “Jo, nuk je gjeneral me shumë yje, por je shqiptar, që duhet të punosh për Shqipërinë. Hiqi ato yje dhe fillo të vendosësh rregullin dhe të punojmë për shqiptarët”.

Ndërkohë, ju që na morët poza...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I hoqi dhe filloi të punojë për Shqipërinë.

Ndërsa juve këtu, që morët pozat e disa nacionalistëve shumë të ndershëm, dua t’ju them se nacionalizmi është streha e fundit e elitave të korruptuara. Nacionalist i mirë është ai që punon për Shqipërinë. Prandaj, punoni dhe ndërtoni politika të mira ekonomike dhe sociale për Shqipërinë, dhe vetëm atëherë ju dhe ne do të jemi nacionalistë të mirë.

Mos e çoni Shqipërinë në zgrip, siç e keni çuar! Mos shëtisni rrugëve të Shqipërisë, por merrni ndërtesat qeveritare, ashtu sikundër fituat zgjedhjet, dhe e dini ju se si, dhe drejtojeni Shqipërinë siç duhet! Atëherë i keni bërë siç duhet detyrat e shtëpisë dhe atëherë do ta çojmë Shqipërinë drejt Europës, siç e dëshirojmë të gjithë!

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Unë kam një mesazh për të gjithë kolegët dhe për medien që na ndjek, si dhe nja dy pyetje për të nderuarin gazetar.

Në radhë të parë, unë distancohem dhe dënoj çdo dhunë jo vetëm ndaj gazetarëve, ndaj qytetarëve, por edhe çdo dhunë politike që bëhet për përdorim pushteti, për marrje pushteti në tavolinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sinqerisht, duke qenë edhe pjesëtar i këtij komisioni, lidhur me mbrojtjen e jetës dhe të drejtave të gazetarëve, ne jemi marrë edhe me një vërejtje që i është bërë një gazetareje nga drejtori i Përgjithshëm i një institucioni, jo më me raste të tilla që, sigurisht se po.

Albana Vokshi – Vërejtja u mor, sepse gazetarja...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Të lutem!

Albana Vokshi – ...informoi për lidhjet e familjarëve të Kryeministrit me drogën!

Ismet Beqiraj – Të lutem, më respekto!

Albana Vokshi – Tani, t’i themi gjërat siç janë!

Ismet Beqiraj – Në rregull, por unë do t’i them ashtu siç i them.

Albana Vokshi – Jo, jo, t’i themi të gjitha!

Ismet Beqiraj – Ama, disa kolegëve deputetë, që janë të rinj në këtë tavolinë, qoftë edhe gazetarë, kur revokojmë ngjarje jo të historisë së largët, por të historisë së demokracisë së Shqipërisë, pas viteve ’90, u duket kiamet i madh dhe thonë pse na i përsërisni. Unë e ndiej, madje e kuptoj më shumë se çdonjëri nga ju, prandaj jo vetëm gazetarit të nderuar, Kasmi, por edhe tre protestuesve të tjerë dhe 11 policëve, u uroj shërim të shpejtë! Sigurisht, në një vend demokratik, ku nuk bën përjashtim Shqipëria, ngjarje me lëndime, në protesta ka pasur, ka dhe do të ketë, nuk janë immune, por duhet të jenë brenda limitit të përdorimit të forcës, brenda limitit të mbrojtjes së jetës të qytetarëve që protestojnë, cilitdo krahu të jenë, por nuk ka qenë kështu në historinë e këtyre 30 vjetëve.

Unë e kuptoj shqetësimin e zotit gazetar për goditjen që ka ngrënë, qoftë edhe të pamerituar, por janë institucionet e drejtësisë që do ta japin atë verdikt. Të gjithë japim opinione dhe bëjmë komente, edhe ne politikanët që jemi këtu në këtë tavolinë, por nuk e kemi ne këtë tagër juridik dhe institucional ta gjykojmë. Ndaj, unë do t’ju nxisja që t’i shkohet deri në fund së drejtës, nga cilado anë qëndroftë ajo, sepse kur nuk na intereson drejtësia, e godasim, ndërsa kur na intereson, e mbrojmë.

Unë që jam këtu, në këtë tavolinë, të kuptoj më shumë se çdonjëri tjetër (nuk do ta përdorja kurrë as në foltoren e parlamentit, as në këtë tavolinë), por e di se çfarë do të thotë dhunë me dinamit në qendrën e votimit dhe atje nuk kam qenë vetëm, por edhe me vëllezërit e mi opozitarë.

Tjetër, e di nga ngjarjet e 26 dhe 28 majit të vitit 1996, janë gjurmë që nuk harrohen. Edhe unë që jam këtu në këtë tavolinë, ish-kryetar bashkie, i shkarkuar brenda natës, kam ndërruar tri qeli nga Mallakastra në Fier dhe më pas këtu, në Tiranë, dhe kam parë kronikë me gazetarë të huaj, të vendit, politikanë të gjakosur në sheshin “Skënderbej”. Më vjen mirë që gjatë jetës parlamentare që ushtroj tani, kam fatin që jam edhe në këtë komision, pavarësisht se nga dita e parë deri sot mikrofonat më shumë përdoren për konsum politik; e di që do të bëhet dhe do të shitet edhe politikë, ama jo politikë që të helmojë zemrat dhe mendjet e njerëzve. Çdo ngjarje ne e analizojmë ku jemi dhe do të jemi në mbrojtjen tuaj.

Por, me të drejtë, jo për të treguar nacionalistin apo patriotin e madh, duhet thënë se asnjë pozitë nuk është e përjetshme në pushtet, opozita është gjithnjë alternativa e parë dhe e mundshme. E di se qysh në ditën e parë të zgjedhjeve opozita ka strategjinë dhe politikën për të ardhur sa më shpejt në pushtet. Ama ne tani, atë që thanë edhe para folësit, edhe kryetarja e citoi, na kanë mbetur edhe 24 ditë për hapjen e negociatave, prandaj duhet të bëjmë paqe politike, paqe shqiptarësh, një *status quo* për gjendjen tonë emocionale dhe politike, në mënyrë që të hapen negociatat, sepse nuk e merr asnjëri flamurin e meritës, por të gjithë do të mbetemi në të njëjtën anije dhe nuk duhet ta pengojmë.

Ne jemi sot në pozitë, ju do të vini nesër në pozitë, sepse kështu është pushteti, nuk është i përjetshëm. Ky është mesazhi që kam për të gjithë, të dy krahëve të politikës: nuk duhet të marrim revansh dhe t'i kthejmë mbledhjet e komisioneve si konferenca shtypi të tribunave të partive politike, pavarësisht se do të bëjmë edhe politikë, ama jo me tepri, kolegë dhe kolege të nderuara.

Unë do t'i bëj këto pyetje edhe për këtë gazetar që, fatmirësisht, është edhe bashkëpatrioti im, një mallakastriot i nderuar dhe i devotshëm në gazetari, që ju e njihni, se më thatë, e dëgjova që kishit 25 vjet eksperiencë. Ashtu siç më dhemb plaga jote në kokë, shpirtërisht, se e kam provuar vetë, ashtu më dhemb edhe kjo dorë e shpuar nga plumbi. Prandaj, miku im i nderuar, unë dua të të bëj këtë pyetje: a ka të krahasuar, me të gjitha dobësitë, mangësitë që kanë strukturat e pushtetit, sjellja e policisë në protestat e sotme me ngjarjen e 21 janarit, ku u përdorën armë nga frëngjia e deriçkave të katit të parë këtu, prapa kurrizit tonë, se na e kujtojnë 21 janarin sikur është në vitin zero?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, një mandat e gjysmë ka!

Mbetën të vrarë katër persona, dhjetëra të tjerë u plagosën dhe ja, viktima, që sot ka azil politik në Belgjikë!

Dëgjova që edhe ju e keni mbrojtur. Atëherë, pyes: a duhet dënuar dhuna që merr jetën për qëllime politike, për të mbajtur karrigen? Më vjen mirë që e thatë edhe përmes një shprehjeje popullore, edhe unë me atë shprehje jam. Ndaj, do t'ju lutesha, zoti Kasmi, nuk jap këshilla, se ju e dini më mirë këtë punë dhe rolin tuaj, që ne të hedhim ura paqeje dhe mirëkuptimi me të gjithë në këto momente historike, jo të ndezim zjarre, si dhe të inkurajoj që t'i shkosh ligjërisht ngjarjes deri në fund!

Faleminderit!

Albana Vokshi – Faleminderit, Ismet!

Unë do t'ju sugjeroja të mos kapeni te 21 janari, se nuk ju bën nder, qoftë kush e thirri, qoftë si e thirri, qoftë si u organizua, qoftë kë vutë përpara, qoftë edhe dhunën që u ushtrua, qoftë edhe pllakat që i hoqët, qoftë edhe makinat që i dogjët e të tjerë. Nuk ju bën nder, prandaj mos u kapni pas 21 janarit, se e keni pikë reference...!

(Deputetja Rista ndërhyr pa mikrofon.)

Adelina, nuk të ndërhyra!

Po, ju i çuat aty! Kërkojuni ndjesë, sepse ju i çuat aty! Ai që është aty përballë i çoi aty, nuk i çuam ne! Kështu që, mos u kapni te 21 janari, sepse e keni pikë të gabuar referimi! Është pika juaj më e errët!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju ushtruat dhunë!

Ne jemi dy modele të ndryshme.

Ismet Beqiraj – Albana...

Albana Vokshi – Kryetari juaj çoi në katër vrasje.

Ismet Beqiraj – ...e kishit mundësinë tetë vjet ta gjykonit dhe të bënit drejtësi!

Albana Vokshi – I yni i tërhoqi protestuesit! Ja pra, modelet e ndryshme!

Ismet Beqiraj – E kishit mundësinë ta gjykonit dhe të bënit drejtësi!

Albana Vokshi – Ismet, të dëgjova!

Nëse ka një emër për Kryeministrin tuaj, është “dhuna”.

I premtuat drejtësi...

(Zoti Beqiraj ndërhyr pa mikrofon.)

Po, po, nuk na impresiononi dot fare!

Modeli ynë është ndryshe nga juaji, ku ish-ministrat digjnin veturat dhe ushtronin dhunë! Jemi ndryshe ne! Kryetari ynë shkon e i tërheq protestuesit, që të mos shkojnë deri te dhuna. Nuk ju bën nder, fare, mos u kapni me 21 janarin, se e keni referencë të gabuar! Madje duhet t'u kërkonit ndjesë!

Sa për atë, që na e tundni, po, po, distancohemi ne nga çdo lloj dhune ndaj çdo gazetari, madje kurdoherë që është ushtruar, sikurse e tha edhe Bledi, në çdo kohë që është ushtruar, por është ngjarje e hetuar ajo! Çojeni edhe ju rastin e Bledit në institucionin e akuzës! Hapni hetim administrativ në polici ose le ta hetojë SHKB-ja se si kanë qenë veprimet e policisë, se si kanë ndërhyrë, a janë bazuar në ligj e në manual, apo i kanë tejkaluar kompetencat e tyre, në bazë të një urdhri? Këtë po kërkojmë edhe ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kështu që, mos krahaso gjëra që janë krejt të pakrahasueshme!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, po, distancohemi edhe ne!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është ngjarje e hetuar nga prokuroria, ka kaluar edhe në drejtësi!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Klevis, je i fundit dhe më duhet ta mbyll!

Klevis Balliu – Po, pra, ta marr fjalën!

Janë disa gjëra që u ngritën këtu, por fillimisht dua të...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A ka mundësi të flas, mor?

Dua ta falënderoj zotin Kasmi që është këtu!

Të jem i sinqertë, mos prisni ndonjë zgjidhje, se nuk është rastësi ajo që ndodhi, por ka qenë e planifikuar dhe ka një sërë gjërash që janë të planifikuara. E them këtë, pasi përpara se të ndodhte kjo, ka ndodhur diçka tjetër, që nuk është as për t'u habitur, madje nuk e kuptoj pse habitemi kaq shumë, që është survejimi i kryetarit të opozitës.

Kur pushtetin e marrin banditë apo diktatorë, dihet ajo që çdo parti politike ose organizatë politike survejohet, përgjohet, është më se normale kur ke Edi Ramën për kryeministër, pra këto gjëra do të ndodhin dhe nuk është për t'u habitur!

Tani, u ngrit shpesh pjesa e 21 janarit dhe nuk mendoj se ka ndonjë gjë më të shëmtuar se të ngresh si flamur katër fytyra të këtyre personave, të cilët kanë dalë atje me bindje dhe vdiqën aty. Këta persona kanë dalë atje me bindjen se Rama mund të ishte diçka ndryshe, që do t'i sillte shëndetësinë falas, që nuk u bë kurrë; që do të luftonte korrupsionin, që e ngriti në kulm; që do të largonte bandat, që i futi në parlament....

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Katër të vrarë, mor! Katër fytyra më ka nxjerrë mua ajo! Katër njerëz, të cilët unë po i mbroj, mor!

(Debat në sallë.)

Ta mbaroj, mor!

Të kërkoj ndjesë, në qoftë se ka ndonjë keqkuptim!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, të kërkoj ndjesë!

(Deputeti Ylli flet pa mikrofon.)

O Fidel, a ka mundësi të mbaroj?

Një minutë!

Të këtyre katër personave...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më falni, keni të drejtë!

Një minutë, mor, ta mbaroj fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Rri aty, të mbaroj pjesën time unë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prit, të mbaroj unë fjalën, pastaj vazhdoni ju!

Tani, katër persona...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në qoftë se u shpreha gabim, kërkoj falje!

Adelina Rista – Të lumtë, kërko falje! Janë katër njerëz!

Klevis Balliu – Patjetër, se nuk e kam për turp!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – Ishin katër baballarë, katër kryefamiljarë!

Klevis Balliu – Unë kërkoj falje, ndërkohë ti vazhdon, sepse ti do t'i përdorësh ata, sepse ke hallin ti... Nuk të vret ty gjë tek ata!

(Kryetarja e komisionit flet pa mikrofon.)

Edhe një herë, për ta përsëritur, në qoftë se u shpreha gabim, kërkoj ndjesë!

Siç po thosha, këta katër persona vajtën atje me besim të plotë, pasi nuk kanë pasur asnjë lidhje, asnjë përfitim, se nuk ishin as ish-ministra apo ish-deputetë, ishin njerëz të thjeshtë, të cilët besonin realisht te ju. Ju i përmendni këta persona sa herë që maxhoranca ndihet keq, sa herë që maxhorancës i plas një Mark Frroku, nxirrni këta persona të nderuar; sa herë që maxhorancës i del Elvis Roshi, nxirrni këta persona, apo edhe sa herë që maxhorancës i del Saimir Tahiri. Pra, ata katër persona nuk janë për t'u përdorur! Kështu siç bëni ju, që i përdorni ata, është një turp i madh! Është aq turp, sa të vjen për të vjellë kur sheh të përdoren njerëz, të cilët kanë dhënë jetën për një besim të tyrin, sepse besuan realisht te kjo parti, që ju sot përfaqësoni; te kjo parti, e cila ka bërë njëmijë e njëqind të zeza, por edhe në kohën e Fatos Nanos, të shtetit më rrumpallë që është parë ndonjëherë në historinë e politikës, banditë, kriminelë dhe mafiozë, kaq të shumtë në numër, nuk kishte, i sollët ju!

Na akuzuat se jemi vrasës. Këtu janë tri parti (LSI, PS, PD), por vetëm njëra prej tyre ka pasur një person që ka goditur me armë deputetët e opozitës. Pse po e përmend këtë? Kur u plagos Azem Hajdari...

E përmend se ju nuk e dënuat, mor zotëri, ju e bëtë kryetar të Partisë Socialiste në Has atë, si e ka pasur emrin; me Edi Ramën në krye të Partisë Socialiste!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E bëtë! E bëtë! E bëtë! E bëtë! E bëtë kryetar të Partisë Socialiste në Has, sepse ju nuk harroni t'i nderoni këta banditë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E treta, në protestën e 21 janarit, a ishte Moisi Habilaj, ai që sillte njerëz nga Vlora për të ardhur te kjo protesta? A ishte Mark Frroku, që sillte njerëz nga Lezha për të ardhur te kjo protesta? A ishte Elvis Roshi, që merrte njerëz nga Kavaja për të ardhur te kjo protesta?

Unë e njoh Mark Frrokun. Ndërkohë që duhej të ishte në burg, se doli nga qelia dhe erdhi

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Me qetësi!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel, po t'ua kishe pasur merakun, nuk rrije atje lart, por zbrisje poshtë dhe dilje përballë, ti së bashku me Edi Ramën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk rrije lart, por zbrisje poshtë. Ti pije çaj me Edin lart dhe njerëzit vriteshin poshtë, se ju nuk u dolët për zot.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ti nuk ishte në protestë. Ku ishte? Ti duhej të ishte në ballë. Pse nuk ishte në ballë ti? Pse i le protestuesit mish për top?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Musa Ulqini - Kjo nuk justifikon asgjë.

Klevis Balliu – Së fundi, protesta e opozitës që ndodhi më 26 maj nuk pati përshkallëzime. E vërteta është se ato përshkallëzime nuk do të ishin as në interes të opozitës, as në interes të maxhorancës e, mbi të gjitha, nuk do të ishin në interes të Shqipërisë, sepse në fund të fundit edhe policët që do të përballeshin aty, edhe ata njerëz,

popull janë. Ne jemi edhe në mbrojtje të tyre. Absolutisht po. Këtë e treguam kur i tërhoqëm protestuesit.

Qytetarët kanë 100 mijë arsye për të hyrë te Ministria e Brendshme dhe për ta shkatërruar komplet. Pse i kanë këto arsye? I kanë, sepse kishim një ministër të Brendshëm, i cili bashkë me kushërinjtë e vet mbolli drogë, kanabis në të gjithë vendin, duke filluar nga Vlora, nga qyteti patriotik, ku është ngritur flamuri i pavarësisë, ku ka mundësi për turizëm e është për çfarë të doni ju; Vlora që nuk është larg Greqisë, në vend që të jetë pasuri kombëtare, këta e kanë kaluar në pasuri të Edi Ramës, duke e mbushur vetëm me drogë.

Sot keni 5 drejtorë policie vetëm nga Vlora, të cilët kanë ikur në drejtim të paditur. Unë nuk ju kam dëgjuar të flisni, ju thoni se keni folur, për këta 5 drejtorë policie nga Vlora, gjatë kohës kur këta kanë qenë në detyrë. Ne kemi bërë shumë deklarata për ta.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Gjatë kohës që ata kanë qenë drejtorë policie, ne kemi bërë një seri deklaratash.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ti nuk ishte në protestë. Ku ishte, te kullat?

Fidel Ylli – Unë isha në mes të bulevardit.

Albana Vokshi – Ne ishim te Ministria e Brendshme, duke mbrojtur qytetarët, duke i tërhequr ata.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vazhdo, Klevis!

Klevis Balliu – Zotëri, përgjegjësia këtu është e një personi të vetëm. Ai person...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju të tjerët nuk keni faj, sepse po ju kërkojnë të argumentoni disa gjëra, që nuk ekzistojnë. E di që jeni në pozitë të vështirë, por këtu faji është i një personi, i Edi Ramës. Ky zotëri erdhi me ndihmën e bandave në pushtet dhe tani do t'u japë paratë, të cilat ato kanë investuar për të. Kush jua dha paratë në vitin 2013? Mark Froku, Elvis Roshi, Armando Prenga, se ju i harroni këta. Në Shqipëri ndodh që harrohet shpejt historia dhe kjo është gjë e keqe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi - Të lutem, Ismet!

Ju folët. Tani lëre të flasë! Ai duroi 5 orë.

Klevis Balliu – Ju sot nuk keni se çfarë të thoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju e mbushët parlamentin me mafiozë, me vrasës, me banditë, me njerëz që janë dënuar se janë marrë me prostitucion.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më thuaj se çfarë ju ka thënë Armando Prenga dhe Mark Frroku për integrimin!

E vetmja gjë që ju ka mbetur të bëni, për ta përmbyllur që të mos zgjatëm, është kjo: ministri i Brendshëm duhet të jepte moralisht dorëheqjen, thjesht për faktin që i vëllai i është implikuar me trafikun e narkotikëve.

E thashë dhe e përsëris edhe një herë: nuk e di nëse Fatmir Xhafaj ka ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me narkotrafikun, dhe s'mund ta them, por ai ka të vëllain të lidhur me këtë.

Shkaku i dytë pse duhet të japë dorëheqjen, është se ka vdekur një djalë në paraburgimin e Korçës dhe nuk është thënë asnjë fjalë për të nga ju. Nuk e di nëse keni deputetë në Korçë, apo jo?

Çfarë ndodhi? Ata policë që ishin atje nuk u hoqën nga puna, por u transferuan. U transferuan, zoti Kasmir. Ju keni shpëtuar mirë, sepse në këtë qeveri ka edhe më keq. Po ashtu, edhe një tjetër në Shkodër.

Për këto arsye ministri i Brendshëm duhet të jepte dorëheqjen. Kurse Kryeministri Rama duhet të japë dorëheqjen, sepse është në interes kombëtar që kjo fatkeqësi kombëtare të largohet një orë e më parë, sepse ky njeri e ka kriter drogën dhe për sa kohë të jetë aty, drogë do të shihni ju brenda partisë suaj dhe drogë do të shohim në brenda institucioneve të shtetit. Nuk largohet dot nga droga ai. Pa drogë ai nuk është në pushtet dhe nuk qeveris dot. Pa drogë ai nuk ka se çfarë të bën, se nuk jeton dot pa të. Kaq!

Faleminderit!

Albana Vokshi - Faleminderit!

Ju jeni i fundit, se duhet ta mbyllim.

Ju njoftoj se ditën e mërkurë në orën 10.00, kemi mbledhje komisioni të thirrur nga deputetët e opozitës për censurimin e portalit www.kryeministri.com.

Bujar Çela – I dashur kryeredaktor,

Të shkuara të harruara!

Shpresoj të jesh i fundit, por protesta e gazetarëve ndaj kësaj dhune është një protestë qytetare normale. Unë shpresoj që të gjithë ne në pozicionet tona...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kryetare, unë shpresoj që të gjithë ne, si qytetarë, duhet të jemi të përgjegjshëm në detyrat tona, duke filluar që nga gazetarët, policët, anëtarët e komisionit, deputetët, sepse në

këtë komision sot kemi bërë pa fund biografite e njëri-tjetrit. Ne jemi vetë me një ngarkesë të paparë.

Po e nis te fundi, aty ku latë të gjitha diskutimet tuaja mbi heroizmin.

Unë nuk dua që Kasmi të keqpërdoret për kauza personale për të plotësuar boshllëqet e krijuara nga 26 maji. Protestuesit nuk i tërhoqi kryetari atë ditë. Është njësoj sikur të thuash: sa mirë është rruar ky qosja! Ajo demonstratë, ajo protestë qytetare shqiptare, nuk ishte protestë. Aty nuk kishte popull, por ishin disa njerëz të mbledhur, të futur në tela, të sjellë me autobusë. Unë kam foto që tregojnë se si kanë marrë me listë karburant.

Albana Vokshi – Prandaj u frikësuar ju? Prandaj ushtruat dhunë ju?

Bujar Çela – Ju lutem!

Ishallah kryetari ju vlerëson, që e vazhduat këtu, në komision, meqë nuk e vazhduat dot atje!

Albana Vokshi – Faleminderit!

E mbylle mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bujar Çela – Tamam si 26 maji famëkeq i vitit 1996.

Albana Vokshi – Prandaj dhatë urdhër ju, që të ushtrohet dhunë ndaj kryeredaktorit të gazetës së opozitës?

Bujar Çela – Unë dua që të gjithë gazetarët dhe të gjitha viktimat të mos keqpërdoren nga politika, se nuk ju bëjnë nder.

Bëjmë mirë të kthjellojmë njëri-tjetrin dhe të bashkohemi, kur bëhet fjalë për Shqipërinë, e cila ka shumë nevojë për kontributin tonë dhe përfundimisht të mos sjellim këtu gënjeshtër si ato me kryetarë të Hasit etj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Ai nuk ka qenë kryetar i komunës atje. Ai ka qenë kryetar komune i pavarur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk ka qenë nga PS-ja. Ai ka qenë një kryetar komune i pavarur.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Po të flasim histori personale, se ku kam qenë unë e se ku ke qenë ti!..

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, mos e përmend historinë e tij!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

Të mos përmendim historinë e Shefqet Musarait: “Ku ishte bej efendi, kur ne luftonim për Shqipërinë?”

Uroj të përfitosh atë për të cilën ke kontribuar! Inshallah të vlerësohet ky shou i madh mediatik në rrugën për të qenë pjesë e Grupit Parlamentar të PD-së në të ardhmen!

Faleminderit!

Albana Vokshi - Faleminderit!

Bledi, dua të ta jap fjalën në fund.

A u ndjeve gjë i keqpërdorur në protestë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta sqarojë pak se ç’detyrë kishte, sepse e mori fjalën me dhjetëra herë dhe jua shpjegoi se për çfarë ishte dhe si u gjend aty. Në vend që të distancoheni nga dhuna e Kryeministrit, ju vazhdoni në të njëjtën linjë.

Bledi, të lutem, se dua ta mbyll! Si u ndjeve? Cila është thirrja juaj e fundit që keni?

Bledi Kasmi – Ju falënderoj për këtë seancë!

Uroj dhe shpresoj të kontribuoj për të pasur një fillim të ri. Gjithmonë ka kohë për të pasur një fillim të ri dhe për t’u distancuar nga dhuna. Dhuna nuk çon askund dhe krijon hakmarrje. Dhuna të fut në rrethe vicioze, prej të cilave nuk do të mund të dalim dot asnjëherë. Nëse dënojmë dhunën, jemi në anën e duhur.

Nëse justifikojmë dhunën, atëherë marrim në mbrojtje dhe i inkurajojmë ata njerëz për të kryer veprime të tilla, edhe në protestat e tjera në të ardhmen.

Ajo çfarë unë kam kuptuar gjatë këtyre 24 vjetëve në profesionin e gazetarit, është se në demokraci nuk ka maxhoranca të përhershme dhe nuk ka opozita të përhershme. Në momentin kur je në maxhorancë dhe inkurajon dhunën, kjo nënkupton që edhe maxhoranca e ardhshme do të bëjë të njëjtën gjë me opozitën e ardhshme. Kjo nuk duhet të ndodhë. Që të mos ndodhë kjo, duhet të fillojmë të ndëshkojmë dhe të distancohemi nga autorët e dhunës së 26 majit ndaj meje dhe ndaj protestuesve të tjerë, të cilët përfunduan pa ndjenja në spital.

Unë dua ta mbyll me një mesazh të shkurtër dhe shumë domethënës, që më ka ardhur nga një shkrimtar, i cili personifikon persekutimin në diktaturë dhe mendjen e lirë. Ai quhet Visar Zhiti dhe sot është në Trupin Diplomatik.

“I dashur Bledi,

Të jam pranë. Qofsh mirë me shëndet dhe të gjitha! Ju e dini mirë, që shpesh shkrimet tona janë shkruar më parë me gjak. Bekuar qoftë gjaku, i cili ushqen fjalën, jo vetëm të lirë, por të lirisë, fjalën e dashurisë dhe të drejtësisë, dhe të dinjitetit të njeriut, sidomos të atyre që u persekutuan tani dhe vazhdojnë!

Shpesh na duan të derdhim gjakun, por jo ne vetë. Unë besoj se gjaku është më i fortë se ata. Po e mbyll siç e nisa. Të jam pranë.

Qofsh mirë me shëndet dhe të gjitha!

Visar Zhiti”

Albana Vokshi – Faleminderit shumë!

Unë besoj se mbas këtyre rreshtave, që dhanë një mesazh shumë të qartë, po e mbyll këtë mbledhje me thirrjen: Të distancohemi nga dhuna! Të gjenden autorët e kësaj dhune dhe urdhëruesit e kësaj dhune! Të fillojë hetimi! Të përshpejtohen, nëse janë hapur, çështjet në organin e akuzës, në prokurori! Të flasë drejtësia!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, këtë po kërkojmë edhe ne, se nuk po lëviz asgjë. Po kërkojmë të gjenden urdhëruesit dhe zbatuesit.

Me mesazhin e paqes së Bledit, dua ta mbyll këtë mbledhje dhe t’ju njoftoj edhe një herë, se ditën e mërkurë në orën 10.00, deputetët e opozitës kanë thirrur një dëgjese me drejtuesit e AKEP-it për mbylljen e portalit www.kryeministri.com.

Milva Ekonomi – Mund të bëj një propozim?

E kam për axhendën e së mërkurës dhe për procedurë. Dëgjesat tona zgjasin. Ne kemi nisur sot në orën 11:00 dhe ora tani është 14:30. Kemi 3,5 orë që po bëjmë këtë dëgjese. Duhet t’i japim vetes një kohë, se dëgjesa nuk mund të jetë pa fund!

Të zbatojmë Rregulloren ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Rregullorja ta jep mundësinë, që të mos të flasim pa fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta jep mundësinë që ta menaxhosh më mirë kohën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e kam me ju, por e kam me ne, të gjithë.

MBYLLET MBLEDHJA

